

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7836 E shtunë 30 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



Asgjë e re nga fronti i protestave

Spërkatja me bojë të zezë e murit të Ministrisë së Brendshme të vendit nga një protestues ishte gjëja e re dhe më e spikatur e protestës së djeshme përpara Kuvendit...  
Vijon në faqen 20


Opinion i Ditës

Nga BEN ANDONI



Shqipëria, Samiti i Poznanit dhe qesja e BE-së?!

Ka një perceptim të ndryshëm në mes të zyrtarëve, publikut, biznesit dhe shoqërisë civile, sa i përket ecurisë së Procesit të Berlinit në vendet e Ballkanit Perëndimor...  
Vijon në faqen 21



Kryetari i PD mbledh tryezën me median

## Basha: Zgjedhjet u blenë me krimin. Rama: Dako fitoi kur Niçja ishte me ju

Kryeministri në Durrës nuk konfirmon kreun e bashkisë. Duma takon Borchardt

Përfshirja në çështjen e blerjes së votave që përmban dosja "339" duket se ka përfunduar përfundimisht kryetarin aktual të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako nga mundësia për të rikandiduar për një mandat tjetër. Ndryshe nga sa ka bërë në shumë prej takimeve "Bashkia që duam", dje në takimin e radhës të mbajtur në Durrës...

Në faqen 2-3

NDERTIMET PA LEJE/ 170 FAMILJET QE PERFITOJNE NGA FONDI FINANCIAR I LEGALIZIMEVE

## KOMPENSIMI I PRONAVE, SI NDAHEN 1 MILION EURO

Emrat që marrin paratë në Tiranë, Elbasan, Vlorë e Shkodër. Përfituesit marrin 70% të vlerës totale të kompensimit. ATP: Shpërndahen 5 kështet e para



(Në foto) Foto ilustruese

Në faqen 6

SHTETET E BASHKUARA

Raporti i DASH: Shqipëria, transit për drogat e forta. Problem korrupsioni

Në faqen 5

KRIMI NE TIRANE

Ekzekutimi i Jurgjen Kurtit, zbulohen dy pistat e hetimit

Në faqen 9

NGJARJA NE TIRANE

Sulmohet me levë dhe thikë kambisti, grabiten 60 mijë dollarë, 1 në pranga

Në faqen 8

EKSPOZITA

Driant Zeneli, fëmijët e minierave të Bulqizës në bienalen e Venecias

Në faqen 12

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT



"DigiGirlz Albania" i kompanisë së njohur Microsoft vjen te "Luarasi"

Në faqen 10



E lidhur me Noizyn? Rike Roçi: Ja kush është dashuria ime

## Gruaja e Saimir Tahirit, shtatzënë me djalin e dytë

"Rally i Princeshave", VIP-at që marrin pjesë. Sakrificat e Einxhel Shkirës

Nga PAMELA ALIAJ

Ardhja në jetë e një fëmije është lajmi më i bukur dhe më i veçantë për një familje. Shumë nga personazhet e njohura mundohen që jetën e tyre private ta mbajnë të fshehtë dhe sidomos larg vëmendjes së medias. Por



së fundmi kemi zbuluar një 'të fshehtë' shumë të bukur. Burime për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" na kanë thënë se bashkëshortja e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, është shtatzënë dhe në javët e fundit të saj. Familja Tahiri së shpejti...

Në faqen 4

# ZGJEDHJET AKUZAT

Valentina Madani

Lideri i opozitës Luzlim Basha, ndau dje me gazetarët shqetësimin e tij për median në Shqipëri. Në diskutimin për "Lirinë e medias në funksion të mbrojtjes së demokracisë", PD në bashkëpunim me shoqatat e gazetareve synon të hartojë një dokument që i jep përgjigje situatës së lirisë së medias në Shqipëri. "Të pranosh atë që ka qenë gabim mendoj se është parakusht për të qenë pjesë e një përpjekje të përbashkët për ta ndrequr. Përpjekja duhet të jetë e përbashkët", theksoi z.Basha.

**PREMTIMI**

Kreu i opozitës premtoi se me ardhjen në pushtet, e djathta do të ndjekë modelin evropian në lidhje me median duke u bazuar së pari, tek shtyllat e demokracisë, siç është ndarja e pushteteve dhe konkurrenca e lirë. Basha përballë gazetarëve e vlerësoi median jo të pavarur. "I kanë kapur të 3 pushtetet, kanë kapur edhe pushtetin e katërt, që është media. Media e kapur është problemi, zgjidhja nuk është vetëm çlirimi i medias, por çlirimi i shoqërisë, çlirimi i demokracisë nga kjo kapje totale", u shpreh ai. Për Bashën media nuk pasqyron interesat e publikut, por ato vetjake. Sipas opozitës këto janë disa nga problemet kryesore me funksionimin e medias: "Së pari, siguria e gazetarëve. Së dyti, problemi i vetëcensurës dhe autocensurës për shkak të trysnive politike dhe varësisë direkte dhe indirekte për të ardhurat e shumë mediave nga pushteti. Së treti, problemi i përdorimit të mediave për avancimin e interesave ekonomike dhe jo për avancimin e interesit publik", tha z.Basha. Madje, kreu i PD-së, pretendon se opozita po zhvendëson vetë median. Në themel të problemit kreu demokrat gjen përsëri sistemin gjyqësor, e si garanci të asaj që premtom bën propozimin. "Dua të shpreh gatishtërinë time që raundin tjetër të kësaj tryeze ne të jemi këtu për të diskutuar dhe për të vendosur së bashku mbi një dokument të përbashkët që do të jetë dhe zotimi ynë dhe garancia për aq sa opozita mund të ofrojë garanci në këtë klimë të helmuar politike se nesër gjërat do të ndryshojnë", theksoi z.Luzlim Basha.

**SIGURIA**

Z.Basha kujtoi problemin e madh të sigurisë së gazetarëve, që sipas tij janë në trysni të vazhdueshme, edhe nën kërcënim. "Problemi i sigurisë së gazetarëve, janë në trysni dhe kërcënimet të vazhdueshme për shkak të

PD, tryezë për median e lirë: Të hedhim bazat për një dokument vetërregullues

## Kriza politike, Basha: Shkak, zgjedhjet e blera me krimin

"Asnjë kufizim në ngjarjet politike të PD"



Kreu i PD-së, Luzlim Basha

detyrës, e kam fjalën për kërcënimet për jetën nga krimi i organizuar që kanë marrë edhe formën e goditjes me armë, censura dhe autocensura për shkak të varësisë direkte apo indirekte nga të ardhurat e qeverisë apo pushtetit. Përdorimi i medias për avancimin e interesave ekonomike dhe jo të interesit publik. Kanë probleme që lidhen me profesionalizmin që kanë çuar me dashje apo pa dashje në braktisjen e medias nga interesi publik, dhe

vënien e saj në shërbim të interesave jo publike deri kriminale", tha Basha. Sipas tij, "problemi kryesor që në shohim në raport me median është pamundësia apo paafërsia për të pasqyruar probleme të thella të shoqërisë, ekonomisë e politikës. Kjo i kthen në kronikanë sipërfaqësor, në vend që të luajnë rol të rëndësishëm siç është ai i humlumtimit. Duhet të denoncojë politika që ta japë media. Na akuzojnë se jemi bërë ne si media, për të plotësuar një

**DEKLARATA**

"Problem, siguria e gazetarëve. Janë nën trysni dhe kërcënimet të vazhdueshme për shkak të detyrës, e kam fjalën për kërcënimet për jetën nga krimi i organizuar që kanë marrë edhe formën e goditjes me armë, censura dhe autocensura për shkak të varësisë direkte apo indirekte nga të ardhurat e qeverisë apo pushtetit", - deklaroi z.Basha.

e vendit tonë drejt standardeve e normave të BE dhe të hapësirë euroatlantike që janë dhe synimi i përbashkët kombëtar i çdo shqiptari dhe objekti më kryesor i PD-së dhe opozitës shqiptare".

**ZGJEDHJET**

Kreu i PD-së shprehu bindjen e plotë se zgjidhja e vetme për krizën ku ndodhet vendi është largimi i Edi Ramës nga posti i kryeministrit. Një ditë pasi rivali politik Rama deklaroi nga parlamenti se zgjedhjet të parakohshme nuk do të ketë, Basha ka theksuar se opozita nuk lëviz nga pozicioni i saj për një qeveri tranzitore që do të punojë për organizimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme. "Shkaku i kësaj krize politike janë zgjedhjet e blera me krimin e organizuar në vitin 2017. Zgjidhja e vetme politike është ajo që ka propozuar PD-ja, është rikthimi i sovranitetit tek populli me zgjedhje të lira e të ndershme dhe parakusht është largimi i Edi Ramës dhe një qeveri tranzitore", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së paraqiti si zgjidhje të situatës propozimin e opozitës për largimin e qeverisë. "Është e qartë për çdo shqiptar, është



Tryeza e djeshme e PD-së me përfaqësuesit e medias

e qartë për mbarë botën demokratike se Shqipëria është në një krizë të thellë politike. Shkaku i kësaj krize politike janë zgjedhjet e blera. Për të mbrojtur veten e tij dhe të gjithë kupolën e organizatës së "Rilindjes" të kapur nga prokuroria në mënyrë zyrtare, në bashkëpunim me rrjetet kriminale të drogës, Edi Rama ka kapur edhe drejtësinë, ka shkatërruar pushtetin e tretë, ka asgjësuar Gjykatën Kushtetuese", - u shpreh kreu i PD-së.

**RAPORTI**

Situatën e krimit, korrupsionit, por edhe medias në Shqipëri, Luzlim Basha deklaroi se e pasqyron më së miri raportin i DASH. Kreu i PD-së pranoi me dhimbje që pas 30 viteve të bëhet sërish një debat i tillë, teksa kujtoi se 10 vite më parë, kur Basha ishte Ministër i Jashtëm, vendi u anëtarësua në NATO, ndërkohe që sot raportin i fundit i DASH tregon se Shqipëria është kthyer në një vend bazë të krimit. "Nuk mundem të mos e them me një trishtim të madh në zemër, 10 vite më parë në këtë javë unë isha ministër i Jashtëm dhe po bëheshim gati për samitin e NATO-s ku më 7 prill përfundoi procesi i anëtarësimit si anëtar i denjë i vendit tonë në Aleancën më të fuqishme politike dhe ushtarake që ka njohur bota. Ishte qeveria amerikane aleatja jonë më e fuqishme në këtë arritje historike. Për ironi të fatit, 10 vjet më pas, pikërisht në javën e përkujtimit të kësaj ngjarjeje madhore raportin i DASH tregon se Shqipëria është kthyer në një vend ku nuk ka siguri, por lulezuan krimi, droga, pastrimi i parave, korrupsioni në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe është kthyer nga një vend bazë sigurie për vendet e tjera, në një bazë të krimit e organizuar që vepron nga Amerika e Veriut dhe Europë deri në Lindjen e Mesme e mbyll citimin e raportit të DASH", -tha Basha.

### "Opozita po shmang përplasjen civile"

## Borchardt takon Dumën: Folëm për çështje të ndryshme me miken e vjetër



fundit kërkojnë me çdo kusht largimin e kryeministrit Edi Rama. Sipas saj akuzat ndaj PD-së për financimet ruse

janë spekulime që dëmtojnë integritimin e vendit dhe mbulojnë dëshitim për hapjen e negociatave. Në kulmin e

klimës së protestave antigeveritare ish-deputetja e PD, shprehet se protesta e 13 prillit pritet të jetë madhështore nisur edhe nga kauza e saj. Publikimi i përgjimeve të funksionarëve të policisë së shtetit sipas Dumës është kolosal dhe janë autopsi e kalbëzimit të shtetit në çdo nivel, ato janë shfaqur në publik pasi prokuroria u përdor politikisht. Duma ironizoi kryeprokurororen Arta Marku duke u shprehur se tashmë ka arritur kulmin e durimit teksa elita e pushtetarëve nuk nënshkohen.





**PËR KRYEMADHIN**

Kreu i qeverisë në fjalën e tij nuk ka lënë pa atakuar edhe kryetaren e LSI-së, të cilën tashmë e thërret "flaxhorja". "I ka thënë flaxhorja kam pa filxhan mbrëmë. Harroje ti do digjesh komplet ndezi fjalët ajo, u hodh Luli në flakë, Saliu benzinë nga pas. Mos u merrzi i thotë flaxhorja, pashë aty një L të madhe dhe një E që po shkote poshtë. Monika i thotë Zotit: Lëri punët e tjera, hajde shpëto shqiptarët nga ata që blejnë vota. Kjo e shkreta që ngelën duke ia blerë, kjo mazalla s'e ka blerë një votë. Kjo të blejë një votë?! Joo, mo, kjo blen çizme", tha Rama.

**SHKURTE**

**Rama në Durrës, protestuesit e opozitës bllokojnë rrugën**

Kryeministri Edi Rama në kuadër të ciklit të takimeve "Bashkia që duam" u ndal dje në qytetin e Durrësit. Por, ashtu si edhe në shumë qytete të tjera ku janë mbajtur takime të kësaj natyre, edhe në Durrës ai është pritur me protesta nga simpatizantë dhe përkrahës të Partisë Demokratike. Protestuesit demokratët ishin ndarë në tri grupe në pritje të Ramës, duke penguar edhe kalimin e mjeteve, në mënyrë që të bënin të pamundur hyrjen e tij në qytet. Protestuesit gjithashtu shpalojnë parullat me mbishkrimet "Rama ik!", "Stop krimi politik!", apo "Ndal shkatërrimit të Durrësit". Kjo nuk është hera e parë që kryeministri Edi Rama është pritur me protesta gjatë vizitave të tij në kuadër të programit të bashkëqeverisjes "Bashkia që duam". Por, pavarësisht pengesave të krijuara në rrugë, kryeministri Rama ka kryer të gjitha takimet e planifikuara. Ashtu edhe dje në Durrës, ai e ka zhvilluar takimin e tij me banorët e Durrësit në një shesh, ku sërish organizatorët ishin përpjekur që të tregonin masivitet dhe mbështetje.

**Bylykbashi ironizon Ramën: Lëri armët e pushtetit dhe dil në betejë**

I vënë në qendër të sulmeve politike të kryeministrit Edi Rama, ish-deputeti PD-së, Oerd Bylykbashi, përmes një postimi në rrjetet sociale e quan Ramën "artist", ndërsa i kujton se nuk ka qenë ndonjëherë, nuk është dhe nuk mund të jetë një jurist. Në këtë kuadër, Bylykbashi e fton Ramën që të hedhë armët e pushtetit, të lërë dhe bandat që e rrethojnë dhe të përballet në kushte të barabarta me opozitën në zgjedhje. "Eh mër artisti! Paska fol artisti nga Tirana. O artist, të kujtohet 2009-ta kur thoshe: Si ma hodhe që mblodhët më shumë vota me koalicion? I madh ishe, kujtoje se koalicioni i madh duhej vetëm për kohë televizive. Koalicioni mblodhi vota, jo kriminelët që mblehdi ti. Po 2011 kur të nxorëm nga zyra të kujtohet? Të prishëm planet e kullave. Kur je artist, mos bëj si jurist! Hidhi armët që të jep pushteti, lëri bandat dhe dil në shesh barabartë dhe të shohim si ikën duke kuisur. Hë artist, ashtu e sheh sa të vlejën bojërat e ujtit që mban mbi tryezë!", - shkroi Bylykbashi.

Kreu i qeverisë deklaroi se nuk do ketë shtyrje të zgjedhjeve vendore

**Rama vlerëson punën e Vangjush Dakos, por nuk jep konfirmimin**

*"Sa herë ju ka rraf Dako, Niçja ishte me ju"*

Përfshirja në çështjen e blerjes së votave që përmban dosja "339" duket se ka përjashtuar përfundimisht kryetarin aktual të Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako nga mundësia për të rikandiduar për një mandat tjetër. Ndryshe nga sa ka bërë në shumë prej takimeve "Bashkia që duam", dje në takimin e radhës të mbajtur në Durrës, kreu i qeverisë, Edi Rama e shmangu konfirmimin e Dakos për një mandat të dytë. Kryeministri në fjalën e tij e vlerësoi punën e bërë nga Dako në këtë bashki, por nuk dha një konfirmim për të siç ka bërë me shumë kryebashkiakë të tjerë, si Sotirajq Filo në Korçë, Dritan Lelin në Vlorë apo Erion Vellajin në Tiranë. Nga ana tjetër, duke i kthyer përgjigje edhe opozitës për zgjedhje të parakohshme së bashku me ato lokalet, Rama tha se zgjedhjet vendore do mbahen në 30 qershor. "Ne jemi duke u përgatitur për zgjedhjet e 30 qershorit, do shkojmë për ato shumë gjëra që duhet të bëjmë. Përpara 4 vitesh ju kemi thënë do zgjidhet problemi i kanalizimeve dhe do jetë drejt zgjidhjes furnizimi me ujë dhe kjo ka ndodhur. Do transformojmë Porto Romanon në një park të ri. Nuk diskutohet se janë një sërë projektesh të mira të kësaj bashkie falë Vangjushit që ka pasur projekte", - tha kryeministri Rama në fjalën e tij. Ai ka përjashtuar gjithashtu çdo marrëveshje që do të cenonte ligjet, duke theksuar se tashmë mundësia për opozitën që të kthehet në Kuvend janë vetëm zgjedhjet vendore të 2021. "Mos dëgjoni jo po do bëhen zgjedhje të parakohshme, jo po do shtyhen, jo po do vijmë ndërkombehtarët do thonë meqë po qan Luli jepi biberonin. I dhamë 15 biberonë para dy vitesh, ai prapë nuk rritet. Le të rrijë në rrugë dhe të forcohet, të bëhet gati më 2021", - tha më tej Rama. Ai nuk ka lënë pa sulmuar edhe ish-deputetin demokrat të Durrësit, Oerd Bylykbashi, duke lënë të kuptohet se ai do jetë kandidati rival për bashkinë e këtij qyteti. "Dëgjova dhe këtë juristin, Bylykbashin, jo nuk hyjmë në zgjedhje: Ti mos hy se i humbur del prapë. Ne do i bëjmë zgjedhjet si me ata, si pa ata. Sa herë ju ka rraf Dako kur e kishit ju qeverinë? Niçja ishte me ju, po kjo nuk na shqetëson. Nuk është detyra jonë të rrisim opozitën. Vazhdojmë rrugën përpara për Durrësin që duam", - tha Rama, duke mos dhënë rikandidim për Dakon.



Kryeministri Edi Rama, dje në Durrës

**DAKO**  
"Dëgjova dhe këtë juristin, Bylykbashin, jo nuk hyjmë në zgjedhje. Ti mos hy se i humbur del prapë. Ne do i bëjmë zgjedhjet si me ata, si pa ata. Sa herë ju ka rraf Dako kur e kishit ju qeverinë? Niçja ishte me ju, po kjo nuk na shqetëson. Nuk është detyra jonë të rrisim opozitën. Vazhdojmë rrugën përpara për Durrësin që duam".

**Vangush Dako nuk heq dorë: Duam të punojmë më shumë për Durrësin**

Pavarësisht se prej disa muajsh është vënë në qendër të kritikave të opozitës për blerje votash dhe bashkëpunim me kontingjentë të krimiit, kryebashkiaku Vangjush Dako nuk ka hequr dorë nga ambicia për të rikandiduar edhe për një mandat tjetër. Duke folur dje në takimin "Bashkia që duam" në prani të kryeministrit Edi Rama, ai tekta renditi punët e bëra gjatë këtij mandati të fundit, theksoi se do të punojë edhe më shumë për transformimin e qytetit. "Dua t'ju falënderoj edhe për të gjithë kontributin që keni dhënë bashkë me ne për transformimin e qytetit. Falënderim Ramës që na ka mbështetur për 12 vite rresht. 4 vite më parë, 56 mijë duarsakë mbështetën drejtimin e duhur si e vetnija rrugë për Durrësin. Sot nuk ndjehemi të zhgënjyer, ne i kemi mbajtur premtimet e 4 viteve më parë. Ky ka qenë mandati i nëntokës, shumë punime qytetarët nuk i kanë parë, por ato investime kanë ndihmuar për



të përmirësuar jetën e tyre. Në muajin qershor do kemi furnizim me ujë të pijshëm për të gjithë qytetin e Durrësit. Duam të punojmë akoma, më shumë, të transformojmë më tej Durrësin për të përmirësuar jetën e qytetarëve", - tha Dako. Ai tha gjithashtu se demokratët s'kanë shanse të fitojnë në Durrës, "pasi qytetarët - tha ai - i kanë dhënë leksion për gabimet e tradhtinë e bërë që nga viti 2007". "Gjatë këtyre kohëve na kanë penguar për Veli-erën, na kanë hedhur balte. E kuptoj që ka edhe kundërshtarë kur bën punë kaq të

mëdha, por në fund jam i lumtur se kur ka debat, punët bëhen më mirë. Më pëlqen që edhe qytetarët japin mendime për qytetin, por nuk jam dakord me ata që na pengojnë me koshiençë. Ne u themi atyre të mos vazhdojnë në këtë rrugë, është faji i tyre që s'kanë leadership e vizion. Nga 2007-ta e deri më sot duarsakët u japin leksion për gabimet e tradhtinë që u kanë bërë banorëve të këtij qyteti. Kemi punuar me shpirt e devotshmëri pa i parë që janë të majtë apo të djathtë, të pasur apo të varfër, nga veriu apo nga jugu", - vijoi Dako.

Gjithashtu, Rama ka ironizuar protestat e opozitës, duke theksuar se qëllimi i tyre është që të marrin pushtetin në tavolinë, pasi me zgjedhje nuk e fitojnë dot. "Këta mësuan një lojë të re, po ikim nga parlamenti, po themi s'duam zgjedhje, po rrimë në rrugë derisa t'i mërzisim të gjithë, derisa të kapim një gjë. Po keni parë që e kapën një gjë në 29017-ën. Se morën gjysmën e qeverisë. E mbani mend kur tha mikui im (Lul-

zim Basha): E rrëzuan gjysmën e qeverisë, tani o burra të rrëzojmë dhe gjysmën tjetër, të hyjmë në zgjedhje dhe vajti ra vetë. Kishte gjysmën e qeverisë, kishte Ministrinë e Brendshme zotëria, të Arsimit dhe Shëndetësisë, të Financave. Dua ALUIZINI-n, po merreni. Dua burgjet, po merrini", - deklaroi Rama. Ai përsëriti edhe një herë ftesën për opozitën që të vijë në tryezën e bisedimeve për të ndry-

shuar Kodin Zgjedhor. "Sa i thamë hajde të bëjmë reformën zgjedhore, na ikën, ja Luli. Por nuk është se nuk do, por mendon se sa më larg të ikë, aq më shumë do të fitojë, mirëpo bëri gabim të madh, se tha: Herën e kaluar pa djeq mandatat mora gjysmën e qeverisë, po sikur t'i djeq të gjitha, mund të mi japin të gjitha dhe mund të mi japin pa zgjedhje, se me zgjedhje e di që s'merr", - u shpreh Rama.

## ANËTARËSIMI CEREMONIA

Presidenti dhe kryeministri kanë marrë pjesë dje në ceremoninë ushtarake

# 10-vjetori i anëtarësimit në NATO, Meta dhe Rama shtrëngojnë duart

Takimi vjen pas deklaratave të forta për krizën

Ceremonia e 10-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, e organizuar dje në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" dhe sheshin "Nënë Tereza" ka shërbyer ndër të tjera edhe për të ulur disi tensionin mes Presidentit të Republikës, Ilir Meta dhe kreut të qeverisë Edi Rama. Për herë të parë që pas betimit si ministër i Jashtëm në Presidencë, gati dy muaj më parë, Meta dhe Rama kanë qënë përballë njëri-tjetrit, çka i ka detyruar që edhe të shtrëngojnë duart së bashku. Në fakt, ka qënë Presidenti Meta ai që pasi bëri parakalimin para Forcave të Armatosura në krah të ministres së Mbrojtjes është ftuar të zërë vend në podium ku dhe ka gjetur kryeministrin Edi Rama. ata nuk e kanë shmangur njëri-tjetrit dhe në mënyrë të paktën formale i kanë dhënë dorën njëri-tjetrit. Pas këtij momenti në respekt edhe të protokollit zyrtar, rasti ka dashur që ata të ulen krah njëri tjetrit, por pasi zunë vend në karriget e tyre nuk ka pasur më komunikim mes tyre, ndërsa janë parë të fokusuar, Rama në fjalim që do të lexonte, ndërsa presidenti në vëzhgimin e sheshit. Ky shtrëngim duarsht vjen pas një sërë deklaratash e kundër deklaratash të forta që kanë lidhje me krizën politike që ka përfshirë vendin, teksa kreu i shtetit u shpreh i gatshëm që për t'i dhënë zgjidhje asaj të sakrifkionte edhe postin e presidentit.

### META

Presidenti i Republikës, në cilësinë edhe të Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, përshëndeti dje ceremoninë e 10-vjetorit të Anëtarësimit të Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut Verior. Kreu i Shtetit nuk harroi të përmendë me vlerësim kontributin e të gjithë spekttrit politik shqiptar dhe të gjitha qeverive shqiptare për arritjen e këtij projekti madhor. "E paçmuar mbetet mbështetja e jashtëzakonshme e të gjithë popullit shqiptar dhe mbarë spekttrit politik e të gjitha qeverive të ndryshme ndaj këtij projekti madhor strategjik që u shërben interesave kombëtare si asnjë projekt tjetër", - nënvizoi ndër të tjera në fjalën e tij Presidenti Meta. Ai theksoi se të gjithë shqiptarët u mbeten përherë mirënjohës SHBA-ve dhe NATO-s për këtë ndërhyrje vendimtare që jo vetëm shpëtoi një popull të pafalshëm, por forcoi paqen dhe sigurinë në rajonin tonë. Meta tha se forcimi dhe fuqizimi i infrastrukturës së sigurisë tonë kombëtare mbetet një prioritet i padiskutueshëm, duke përmendur edhe rritjen e buxhetit.

### RAMA

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast përshënd-



### META

"E paçmuar mbetet mbështetja e jashtëzakonshme e të gjithë popullit shqiptar dhe mbarë spekttrit politik e të gjitha qeverive të ndryshme ndaj këtij projekti madhor strategjik, që u shërben interesave kombëtare si asnjë projekt tjetër", - nënvizoi ndër të tjera në fjalën e tij Presidenti Meta.

## Ceremonia, avionët reaktivë të NATO-s fluturojnë mbi Tiranë

Tirana priti dje për herë të parë një përfaqësi kaq të madhe ushtarake të Aleancës së Atlantikut të Veriut. Me rastin e 10-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO u organizua dje një nga ceremonitë më spektakolare të parakalimit të forcave ushtarake, mjeteve dhe flumujve të vendeve anëtare të Aleancës. Natyrisht që ata që i kanë dhënë në shumë hijeshi kësaj ceremonie kanë qënë fluturimi i disa avionëve të NATO-s në qiellin shqiptar. Presidenti i Republikës Ilir Meta, njëkohësisht Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, kryeministri Edi Rama, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigadë Bardhyl Kolllaku, atashë ushtarake, drejtorë të Ministrisë së Mbrojtjes,



### MINISTRJA XHAÇKA


"Shqipëria është prova e gjallë që edhe një vend i vogël, me mundësi të kufizuara, mund të kthehet në një aset për një aleancë si NATO. Vështirë ta besonte kush 10 vjet më parë, por sot Shqipëria është një eksportues sigurie, pjesëmarrëse në iniciativat dhe misionet e drejtuara nga NATO në Afganistan, Kosovë dhe Letoni Egje, në Prezencën e Përpunuar të NATO-s në Detin

ambasadorë dhe atashë ushtarake të akredituar në vendin tonë si dhe përfaqësues nga 29 vendet anëtare të NATO-s, por edhe qytetarë të Tiranës kanë shijuar spektaklin në qiell të dhuruar nga avionët e NATO-s, të cilët kanë zhvilluar një fluturim

clirimin e Kosovës Shqipëria përgatitet të nisë veprën e rëndësishme të ndërimit të bazës së NATO-s në Kuçovë që do të jetë një prej bazave më moderne dhe më të mëdha të NATO-s në rajon. Ky fakt është simbolikë e bukur e këtij jubileu, sepse baza e konceptuar si një nga pikat

demonstrativ në qiellin shqiptar. Drejtuesit e NATO-s kishin marrë vendimin për të zhvilluar këtë fluturim demonstrativ, në shenjë falënderimi e mirënjohje për kontributin e Shqipërisë në NATO, në 10-vjetorin e anëtarësimit.

e referimit të aleancave tona do të shndërrohet nga një bazë e lindur për t'u mbrojtur nga NATO në bazë të rilindur të NATO-s", - tha kryeministri. Ndër të tjera kreu i qeverisë, apeloj për një anëtarësim sa më të shpejtë edhe të Kosovës në aleancën euroatlantike.



Presidenti Ilir Meta, kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, dje në 10-vjetorin e anëtarësimit në NATO

## Kryemadhi: Lufta për demokracinë, përpjekje për të forcur NATO-n

Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi ka përshëndetur 10-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO duke iu shprehur mirënjohje SHBA-ve, si mbështetja vendimtare për anëtarësimin në NATO. Njëpërmjet një statusi në rrjetet sociale Kryemadhi theksoi se lufta për mbrojtjen e vlerave të demokracisë është përpjekje sublimë për të forcur NATO-n. "10 vite më parë, më 1 prill 2009, Shqipëria shënoi ngjarjen më të rëndësishme në historinë e saj moderne, anëtarësimin në Aleancën e Atlantikut Verior. Sot është dita për të shprehur mirënjohje të veçantë për aleatin tonë strategjik, SHBA, i cili ka qënë mbështetja vendimtare për aftësimin dhe anëtarësimin e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s. Anëtarësimi në Aleancë e rreshtoi Shqipërinë mes kombeve të tjera partnere që kontribuojnë dhe garantojnë sigurinë kolektive, në funksion të paqes dhe zhvillimit në zonën Trans-Atlantike dhe përtej saj", - shkroi Kryemadhi. Ajo theksoi se LSI ka dhënë një kontribut të vazhdueshëm për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. "Si kryetare e LSI-së, dëshiroj të vlerësoj gjithë kontributin që ka dhënë kjo forcë politike për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO dhe në marrëdhëniet me të, si dhe të garantoj për vazhdimësinë në rritje të këtij kontributi në të ardhmen", - u shpreh Kryemadhi.



## Berisha: Merita e anëtarësimit e PD, Metës dhe Majkos

Ish-kryeministri Sali Berisha, 10-vjet pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, meritën ia njeh jo vetëm Partisë Demokratike e qeverisë së tij në përmbushjen e reformave, por edhe disa prej figurave kryesore nga radhët e socialistëve të kohës, që ai thotë se qënë promotorë të kësaj ëndrrë në fushën e sigurisë. "Është forca e parë politike në Europën ish-komuniste që do kërkonte anëtarësimin e vendit të saj në NATO. Falë një përpjekje të madhe të reformave të PD dhe koalicionit, PS në vitet '92 dhe '96, votonte rezoluta anti-NATO. Por ka patur një pjesë, jo e gjithë opozita. Dua t'i shpreh nderimin tim sot Presidentit Meta dhe ish-kryeministrin Pandeli Majko, dhe ata janë promotor në PS për anëtarësimin e të Shqipërisë në NATO", - tha Berisha.





**DOSJA**

Ish-deputeti i LSI, Petrit Vasili akuzoi dje drejtësinë se po bllokoi dosjen e shumë përfolur, 339. Vasili shprehet me ironi se drejtësia e "re", e ka bunkerizuar këtë dosje, që drejtësia e vjetër e krijoi. "Drejtësia e "re" e bllokoi dhe bunkerizoi dosjen 339, që drejtësia e vjetër e krijoi? Ç'farë dreq drejtësi e re është kjo?", tha Vasili.



**LSI: Të mbajnë përgjegjësi shkaktarët e situatës**

**Raporti i DASH, PD: Zgjidhja, shembja e pushtetit të kriminalizuar**

PD dhe LSI reagan dje pas publikimit të raportit vjetor për Shqipërinë nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Ish-deputeti Enkelejd Alibeaj e cilësoi raportin si projektin me të cilin Rama erdhi në pushtet. "Raporti më i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit skanon qartë gjendjen alarmante ku e ka futur vendin qeverisja kriminale e Edi Ramës. Edi Rama dhe qeveria e tij kriminale arriti ta klasifikojnë Shqipërinë si prodhuese dhe eksportuese të sasive domethënëse të marijuanës. Narkoshteti i instaluar është realiteti i hidhur që u ofrohet shqiptarëve. Që Shqipëria të mos shërbejë si bazë për veprimtarinë e organizatave kriminale rajonale, siç thekson raporti i DASH, është e domosdoshme që të largohet përgjegjësi i kësaj situatë. Zgjidhja e vetme e mbetur është vetëm shembja e domosdoshme e këtij pushteti të kriminalizuar", tha z. Alibeaj. Ndërsa Luan Rama i LSI-së kërkoi që shkaktarët e gjendjes që parashtron raporti të mbajnë përgjegjësi. "Është urgjente, është alarmante që shkaktarët e këtij realiteti të mbajnë përgjegjësi, që ata që e kanë stimuluar dhe e kanë ushëruar këtë realitet, që e vë Shqipërinë nën akuzë, të përgjigjen, sepse nuk mund të vazhdohet edhe të jesh vend anëtar i NATO-s, edhe të jesh portë e kalimit të trafiqeve të drogave të forta, edhe të jesh vend anëtar i NATO-s, edhe të jesh vend ku korrupsioni zyrtar është i përhapur dhe nxit një mjedis, ku trafikantët e drogës janë mjaft të aftë të veprojnë pa u ndëshkuar", theksoi z. Rama.

"Korrupsioni në qeverisje e kufizon efektivitetin e luftës kundër narkotikëve"

**Raporti i DASH: Shqipëria, vend transit për drogat e forta**

"Trafikantët, të aftë të veprojnë pa u ndëshkuar"

Departamenti Amerikan i Shtetit i dorëzoi të enjten Kongresit raportin vjetor për strategjinë e luftës ndërkombëtare kundër narkotikëve. Në pjesën për Shqipërinë, DASH thotë se ky vend është njëkohësisht burim i kanabisit dhe gjithnjë e më shumë, një vend transit për kokainën dhe heroinën. Sipas VOA, në këtë raport që mbulon vitin 2018, Departamenti i Shtetit thotë se transiti i kanabisit, si dhe i drogave të forta komandohet kryesisht nga elementë të kimit të organizuar, që transferojnë droga të paligjshme nga vendet burim për në tregjet evropiane. Vëllimi i konfiskimeve të drogës dhe arrestimet e lidhura me drogën në vitin 2018 - thuhet në raport - ishin me rëndësi, të nxitura kryesisht nga bashkëpunimi i organeve ligjzbatuese me partnerët ndërkombëtarë, presioni ndërkombëtar në rritje dhe përpjekjet e Shqipërisë për të hyrë në Bashkimin Europian. Sipas raportit, roli i Shqipërisë si burim apo treg për droga të paligjshme përtej kanabisit është i vogël, por ka pasur një rritje në konfiskimet e kokainës që kalon nëpër Shqipëri për në Europë, përveç zbulimit të laboratorëve të përpunimit të heroinës dhe kokainës në Shqipërinë Veriore dhe Qendrore. "Grupet kriminale shqiptare e trafikojnë kokainën dhe heroinën drejt tregjeve evropiane nga vendet burimore në Amerikën e Jugut dhe Azi". Në raport thuhet se korrupsioni në të gjitha nivelet e qeverisjes e kufizon efektivitetin e përgjithshëm të luftës kundër narkotikëve. Korrupsioni zyrtar - thuhet aty - është i përhapur dhe nxit një mjedis në të cilin trafikantët e drogës janë mjaft të aftë të veprojnë pa u ndëshkuar. Sipas raportit, përpjekjet për të çrrënjësuar kanabisin dhe ndjekur penalisht kultivuesit e tij kanë qenë të gjera, por jo kudo njëjloj dhe ndërhyrja në infrastrukturën e trafikimit të drogës, që është krijuar gjatë dy dekadave përbën një sfidë. Raporti thotë se shkalla e lartë e papunësisë dhe sundimi i dobët i ligjit kanë krijuar një ambient ideal për grupet e kriminit të organizuar, që shkaktojnë problemin e kontrollit të drogës në Shqipëri. Në pjesën e raportit për pastrimin e parave, Departamenti i Shtetit thotë se gjatë vitit 2018 qeveria e Shqipërisë nuk bëri përparim të rëndësishëm për parandalimin e

pastrimit të parave dhe krimeve financiare. Si shkak për këtë, raporti e vë gishtin te korrupsioni, rritja e rrjeteve të kimit të organizuar dhe institucionet e dobëta ligjore dhe qeveritare. Në raport thuhet se ekonomia e vendit operon në masë të madhe me 'cash' dhe në mënyrë informale, me hyrje të konsiderueshme të parasë nga

jashtë në formë të dërgesave të emigrantëve. Krimet që gjenerojnë më shumë para në Shqipëri janë trafikimi i drogës, evazioni fiskal dhe kontrabanda, sipas DASH. Elementë të tjerë me rëndësi në këtë aspekt, sipas raportit, janë falsifikimi, kontrabanda e armëve dhe trafikimi i qenieve njerëzore. Shqipëria - thuhet në raport -

shërben si bazë operacionesh për grupet e kriminit të organizuar që veprojnë në Shtetet e Bashkuara, Evropë, Lindjen e Mesme dhe Amerikën e Jugut. Reformat e fundit në drejtësi, verifikimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për korrupsion dhe për lidhjet me krimin e organizuar si dhe krijimi i një task-force policoe, që synon aktivitetet e kriminit të organizuar - thuhet në raport - kanë krijuar një trajektore pozitive që Shqipëria të trajtojë çështjen e pastrimit të parave dhe të krimeve financiare. Megjithatë, përfundon raporti i DASH - korrupsioni i përhapur përbën një sfidë për zgjidhjen e tyre. Raporti vjetor për strategjinë e luftës ndërkombëtare kundër narkotikëve, i kërkua nga Kongresi dhe i ndarë në dy vëllime vlerëson përpjekjet e qeverive të huaja për të reduktuar prodhimin, trafikimin dhe përdorimin ilegal të drogës, si dhe punën e tyre për të luftuar pastrimin e parave që lidhen me trafikimin e drogës. Raporti nisi të botohej në vitin 1986 dhe publikimi i tanishëm mbulon vitin kalendarik 2018.



**GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT TË DASH**

- Shqipëria shërben si bazë operacionesh për grupet e kriminit të organizuar që veprojnë në Shtetet e Bashkuara, Evropë, Lindjen e Mesme dhe Amerikën e Jugut.
- Ekonomia e vendit operon në masë të madhe me 'cash' dhe në mënyrë informale, me hyrje të konsiderueshme të parasë nga jashtë në formë të dërgesave të emigrantëve. Krimet që gjenerojnë më shumë para në Shqipëri janë trafikimi i drogës, evazioni fiskal dhe kontrabanda.
- Vëllimi i konfiskimeve të drogës dhe arrestimet e lidhura me drogën në vitin 2018 ishin me rëndësi, të nxitura kryesisht nga bashkëpunimi i organeve ligjzbatuese me partnerët ndërkombëtarë, presioni ndërkombëtar në rritje dhe përpjekjet e Shqipërisë për të hyrë në Bashkimin Europian.
- Roli i Shqipërisë si burim apo treg për droga të paligjshme përtej kanabisit është i vogël, por ka pasur një rritje në konfiskimet e kokainës që kalon nëpër Shqipëri për në Europë, përveç zbulimit të laboratorëve të përpunimit të heroinës dhe kokainës në Shqipërinë Veriore dhe Qendrore.
- Korrupsioni në të gjitha nivelet e qeverisjes e kufizon efektivitetin e përgjithshëm të luftës kundër narkotikëve. Korrupsioni zyrtar është i përhapur dhe nxit një mjedis në të cilin trafikantët e drogës janë mjaft të aftë të veprojnë pa u ndëshkuar.
- Përpjekjet për të çrrënjësuar kanabisin dhe ndjekur penalisht kultivuesit e tij kanë qenë të gjera, por jo kudo njëjloj dhe ndërhyrja në infrastrukturën e trafikimit të drogës, që është krijuar gjatë dy dekadave përbën një sfidë.
- Shkalla e lartë e papunësisë dhe sundimi i dobët i ligjit kanë krijuar një ambient ideal për grupet e kriminit të organizuar, që shkaktojnë problemin e kontrollit të drogës në Shqipëri.

**Shoqëria përparimorë JUSTITIA**

Shoqëria përparimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e DYTE, për shitjen e pasurisë së palauzgjatshme për të cilin ka vendin hipotekë: NIBG BANKAËBË BANG, me këto të dhëna: Nr. 1787-N1, ZK. 8562, VOL. 30, FAD. 71 e llogji njësi me sip. 109 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babani", Korçë në pronësi të Pandeli Bonja. Çmimi me të cilin fillon ankandi është në vlerën 48.832 EURI (dyzetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) EUR. Nr. 1787-N3, ZK. 8562, VOL. 30, FAD. 93 e llogji njësi me sip. 89.2 m2 ndodhur në adresën Rruga "Fuat Babani", Korçë në pronësi të Pandeli Bonja. Çmimi me të cilin fillon ankandi është në vlerën 39.961 EUR (tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një) EUR. Ankand i zhvilluar në datën 29.04.19, në përfaqësim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21, Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890

**Ambasada SHBA: Reforma në drejtësi nuk do të ndalet**

Ambasada e SHBA-ve në Tiranë shprehet se reforma në drejtësi është në rrugën e duhur dhe se, "Shqipëria shumë shpejt do ketë një sistem drejtësi të ndershëm". Në një postim në faqen zyrtare "Facebook", ambasada qetësoi shqiptarët, duke theksuar se reforma në drejtësi nuk do të ndalojë. "Reforma në drejtësi vazhdon të ecë përpara, në rrugën e duhur, sipas planit. Shtetet e Bashkuara janë krenare për ndihmën që po u jepet këtyre institucioneve ndërsa ecin përpara. Shqipëria do të ketë shumë shpejt sistem-in e ndershëm dhe transparent të drejtësisë, që Kush-tetuta parashikon. Qytetarët shqiptarë duhet të ndihen të sigurt për këtë gjë, reforma në drejtësi nuk do të ndalojë", thuhet në deklaratën e Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë.

Agjencia e Trajtimit të Pronave, 123 milionë lekë për tokat e zëna nga ndërtimet pa leje

# Kompensimi i pronave, lista e re me 169 përfituesit

## Përfituesit marrin 70% të vlerës totale

Agjencia e Trajtimit të Pronave, ka përfunduar procesin e shqyrtimit për 169 pronarë të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimet informale, që përfitojnë deri më tani kompensimin në vlerë, në masën 70% të shumës së përgjithshme në të holla. Shuma e vënë në dispozicion të pronarëve është 123 milionë lekë. Të dhënat në lidhje

me pasuritë që kompensohen dhe mbi gjerat e subjekteve të subjekteve përfitues publikohen sot në "Gazetën Shqiptare". Agjencia e Trajtimit të Pronave njofton subjektet e interesuara se vlerat përkatëse për secilin përfitues do të jenë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë pas përfundimit të procedurave të transfertave bankare në ditët në vazhdim.

### KOMPENSIMI

Agjencia e Trajtimit të Pronave bën të ditur se për 169 pronarë, për të cilat ka përfunduar procesin e shqyrtimit nga ana e ATP-së, ka rezultuar se dokumentacioni i tyre është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e

pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale", i ndryshuar: "Pronarët përfitojnë këstin e parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të kompensimit në të holla në një total prej 70% të vlerës totale të miratuar me VKM-të përkatëse. Fondi financiar që shpërndahet nga ATP për këto 169 kërkesa, është në vlerën 123 666 518,52 lekë"-thuhet në njoftimin e ATP-së.

01.10.2012	AHMET	SULEJMAN	KOTORI	TIRANE
02.10.2012	YLLI	SULEJMAN	KOTORI	TIRANE
13.05.2014	GAZMIR	SYRJA	ZEQIRAJ	TIRANE
13.05.2014	DURIM	PRENJO	RODAKAJ	TIRANE
21.09.2016	MYRTEZA	REIZ	POSHI	VLORE
23.09.2016	ELSA	REIZ	KUMI	VLORE
23.11.2016	ARBEN	RESUL	IDRIZI	ELBASAN
17.01.2017	BEDRI	LATIF	XHAMETA	TIRANE
24.01.2017	BLEOAR	LATIF	XHAMETA	TIRANE
24.01.2017	ENVER	LATIF	XHAMETA	TIRANE
01.02.2017	EDGARD	NAZMI	MYSHKETA	VLORE
20.03.2017				VLORE
01.02.2017	EDLIRA	NEHAT	KRYEZIU	VLORE
01.02.2017	LIJANA	ARIAN	MYSHKETA	VLORE
07.02.2017	FESTIM	QERIM	XHAMETA	TIRANE
07.02.2017	GEZIM	HASAN	XHAMETA	TIRANE
03.03.2017	SADIK	HASAN	XHAMETA	TIRANE
07.03.2017	FATMIR	ALI	TOPI	TIRANE
17.03.2017	SHPRESA	ALI	PESJAKA	TIRANE
24.03.2017	GEZIM	ALI	TOPI	TIRANE
30.03.2017	FATOS	LATIF	XHAMETA	TIRANE
24.04.2017	MUHARREM	HASAN	XHAMETA	TIRANE
05.05.2017	ELIZANA	GANI	XHAMETA	TIRANE
29.06.2017	SANIJE	QAZIM	ALDISHA	TIRANE
25.09.2017	KASEM	HAMID	XHAMETA	TIRANE
01.11.2017	GRETA	AGIM	SINANI	ELBASAN
02.02.2018	BUJAR	LATIF	XHAMETA	TIRANE
19.02.2018	FERIK	MANE	LULA	DURRES
19.02.2018				DURRES
19.02.2018				DURRES
19.02.2018				DURRES
19.02.2018				DURRES
19.02.2018				DURRES
20.02.2018	ADRIANA	BAJRAM	ÇOHO	TIRANE
28.02.2018	ANILA	ADIL	BOZGO	VLORE
26.03.2018	DHIMITRA	DHIMITER	SHAHU	ELBASAN
18.06.2018	ENRIETA	SELIM	VOZGA	TIRANE
26.09.2018				TIRANE
20.06.2018	KUTIM	RESHIT	BEVAPI	ELBASAN
21.06.2018	FATLINDA	ALI	STRUGA	TIRANE
21.06.2018				TIRANE
23.06.2018	ZEGJINE	RESHIT	KAÇI	ELBASAN

29.06.2018	HAXHIRE	QAZIM	DISHA	TIRANE
29.06.2018	ISMETE	QAZIM	BERONI	TIRANE
29.06.2018	MUHARREM	QAZIM	DISHA	TIRANE
29.06.2018	QEFERE	QAZIM	BRAHJA	TIRANE
29.06.2018	QAZIM	QEMAL	DISHA	TIRANE
29.06.2018	LORENC	QEMAL	DISHA	TIRANE
02.07.2018	EDMOND	BEROM	DYLQESHI	TIRANE
02.07.2018	ENGJËLLUSHE	XHEVDET	NASUFI	ELBASAN
03.07.2018	FATJON	IRFAN	KONXHOLLU	TIRANE
09.07.2018	NADIRE	MYRTEZA	BACELLI	TIRANE
16.07.2018	ARIANA	RAMAZAN	PECANI	TIRANE
16.07.2018	BUJAR	OSMAN	DEMNERI	TIRANE
16.07.2018	FRENS	NIRVAN	DEMNERI	TIRANE
18.07.2018	DENI	HYQMET	GURABARDHI	TIRANE
19.07.2018	BRUNO	THESAR	BEJLERI	TIRANE
25.07.2018	ESHREF	SALI	DEMNERI	TIRANE
25.07.2018	MERITA	VELI	DEMNERI	TIRANE
27.07.2018	VERA	ENVER	KOÇI	TIRANE
27.07.2018				TIRANE
27.07.2018				TIRANE
30.07.2018	MEXHIT	QAZIM	DISHA	TIRANE
07.08.2018	AFERDITA	XHAFAER	DALLIU	TIRANE
20.08.2018	ARBEN	ALI	DEMETI	ELBASAN
21.08.2018	INGRIT	BAJRAM	DEMNERI	TIRANE
28.08.2018				TIRANE
28.08.2018				TIRANE
23.08.2018	YLLI	NAIM	JASA	TIRANE
23.08.2018	MIMOZA	NIKOLLA	SHUTURIQI	TIRANE
30.08.2018	MIMOZA	ASLLAN	BRAHJA	TIRANE
06.09.2018	BESIM	XHEMAL	SAUKU	TIRANE
06.09.2018				TIRANE
06.09.2018				TIRANE
11.09.2018	FELIKS	NAIM	JASA	TIRANE
11.09.2018	AGIM	NAIM	JASA	TIRANE
13.09.2018	ANDI	YLLI	RESULI	LEZHE
13.09.2018	ERMIRA	SIRI	JASA	TIRANE
04.10.2018	ERVIN	NJAZI	ÇIMA	TIRANE
04.10.2018				TIRANE
04.10.2018				TIRANE
15.10.2018	ELIDA	SEFEDIN	AGOLLI	ELBASAN
22.10.2018	ANILA	NIKOLLAQ	SHAMETI	TIRANE
08.03.2019				TIRANE
22.10.2018	ARBEN	ABDYL	CANI	TIRANE

09.11.2018	HENRIETA	SEFEDIN	BALIU	ELBASAN
12.11.2018	ILIR	SAMI	PILACA	SHKODER
12.11.2018	ENGJËLLUSHE	SEFEDIN	AMETLIARI	ELBASAN
12.11.2018	SUELA	BAJRAM	DEMNERI - HAATAJA	TIRANE
12.11.2018				TIRANE
12.11.2018				TIRANE
14.11.2018	BARDHYL	ISUF	HOXHA	SHKODER
14.11.2018	ARIAN	ASTRIT	KADILLI	ELBASAN
15.11.2018	BRIXHILDA	MIHAL	JASA	TIRANE
15.11.2018				TIRANE
20.11.2018	DASHAMIR	RIZA	LUNIKU	ELBASAN
04.12.2018	MARIETA	VELI	LEKA	ELBASAN
04.12.2018				ELBASAN
04.12.2018				ELBASAN
04.12.2018	ZHANETA	VELI	DHAMA	ELBASAN
04.12.2018				ELBASAN
04.12.2018	EDUART	VELI	SINA	ELBASAN
04.12.2018				ELBASAN
04.12.2018				ELBASAN
12.12.2018	IRMA	ZIJA	LIXA	ELBASAN
12.12.2018	FATMIRA	ZIJA	ZGJANI	ELBASAN
12.12.2018	LIJANA	ASTRIT	BIXHEKU	ELBASAN
12.12.2018				ELBASAN
12.12.2018				ELBASAN
12.12.2018	ZYRA	VELI	MARKU	ELBASAN
12.12.2018				ELBASAN
12.12.2018				ELBASAN
21.12.2018	ADEM	RUZHDI	BALLIÇI	ELBASAN
27.12.2018	BRIKENA	SEZAI	BAXHAKU	ELBASAN
27.12.2018	HASAN	SELMAN	BEKA	TIRANE
27.12.2018				TIRANE
27.12.2018				TIRANE
28.12.2018	BLENDI	MUSA	BAKALLI	ELBASAN
28.12.2018	HERGI	FISNIK	TABAKU	TIRANE
03.01.2019	ARBEN	HASAN	ALUSHI	ELBASAN
03.01.2019				ELBASAN
03.01.2019				ELBASAN
10.01.2019	SUZANA	BESIM	HALLI	ELBASAN
11.01.2019	MEREME	HASAN	BUHARAJA	ELBASAN
11.01.2019				ELBASAN
11.01.2019				ELBASAN
16.01.2019	AGRON	HYSN	SHARRA	ELBASAN
22.01.2019	DRITAN	SADIK	ÇENGELI	ELBASAN
23.01.2019	QAZIM	XHEMAL	XHEPA	ELBASAN
23.01.2019	ERJON	HAMDI	BILALI	TIRANE
23.01.2019				TIRANE
23.01.2019				TIRANE
23.01.2019				TIRANE
23.01.2019	AIDA	FATOS	GASHI	ELBASAN
31.01.2019	ARBEN	BARDHYL	MIRAKU	ELBASAN
31.01.2019				ELBASAN
31.01.2019				ELBASAN
26.02.2019				ELBASAN
31.01.2019	MEVLUDE	HASAN	MIRAKU	ELBASAN
31.01.2019				ELBASAN
05.02.2019				ELBASAN
05.02.2019				ELBASAN
05.02.2019				ELBASAN
26.02.2019				ELBASAN
26.02.2019				ELBASAN
04.02.2019	JULIAN	SEIT	ZAJMI	TIRANE
07.02.2019				TIRANE
08.02.2019	DRITAN	SEIT	ZAJMI	TIRANE
13.02.2019				TIRANE
08.02.2019	JULEDA	KUDRET	FALLANAJ	VLORE



Pronat në bregdet, hartat me zonat ku pezullohet kalimi i titujve

# Tokë me '7501'-ishin, pezullohen dhënie e tapive në 67 zona

Lista me 12 qytetet ku ndalohet dhënia e tapive

Zbardhet harta me 67 zona në gjithë vijën bregdetare ku është pezulluar dhënia e tapive për tokat bujqësore që janë shpërndarë me ligjin 7501. Një vendim i publikuar dhe në Fletoren Zyrtare përmban 67 harta me zonat e sakta që do t'i shërbejnë njësive vendore si orientim për të bërë pezullimin e kalimit në pronësi të përfuturësve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit në mbështetje të projekteve investuese në turizëm. Sipas vendimit mësohet se ngarkohet Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol për vijimin e procedurave të regjistrimit, sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin fillestar të pasurive të paluajtshme. Pasuritë e paluajtshme, që ndodhen në zonat në të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, regjistrohen në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit fillestar.

**VENDIMI**

Vendimi thotë se Këshilli i Ministrave vendosi pezullimin e përkohshëm të vijimit të procedurave të kalimit



Harta me zonat e sakta, që do t'u shërbejnë njësive vendore

në pronësi të përfuturësve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, në mbështetje të projekteve investuese në turizëm, sipas hartës bash-

këlidhur këtij vendimi, publikuar edhe në Gjeoportalin Kombëtar, të administruar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), deri në kalimin/regjistrimin e pasurive të

## Pronat në Himarë, Tsipras mesazh "kërcënues" Tiranës zyrtare

Kryeministri i Greqisë, Alexis Tsipras, ka reaguar kashpër sot për pronat e banorëve të Himarës. Gjatë samitit mes katër shtetesh të zhvilluar në Bukuresht, konkretisht mes Greqisë-Rumanisë-Serbisë-Bullgarisë, kreu i qeverisë greke tregoi se Shqipëria mund të përballtet me sanksione. "Kohët e fundit po shikojmë zhvillime që nuk na pëlqejnë. Sot mësova që ka pasur një zhvillim negativ në lidhje me minoritetin grek. Nëse është e vërtetë, do të jetë një zhvillim shumë negativ. Një çështje që fatkeqësisht neve nuk na jep optimizëm drejt perspektivës europiane. Nëse informacioni që kemi është i vlefshëm, nuk ekzistojnë parakushte për të ecur në këtë drejtim. Shpresoj të jem i gabuar, sepse dëshira e të gjithëve është që hapat drejt perspektivës europiane të bëhen realitet. Por, në çdo shtet e shikojmë veç e veç", tha ai. Sipas medive greke, Tsipras i referohej një informacioni që kishte marrë se konkretisht qeveria shqiptare ka konfiskuar pronat të minoritetit grek në Himarë, përmes një vendimi të botuar në Fletoren Zyrtare.

paluajtshme shtetërore, në zbatim të nenit 34, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, dhe të akteve të tjera nënligjore në fuqi. Në pikën 2 të vendimit thekson se harta bashkëlidhur këtij

vendimi përfshin pasuritë e paluajtshme, të evidentuara në zonat kadastrale, të miratuara me vendimet e Këshillit të Ministrave, nr. 707, datë 21.11.2018, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të

ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Shkodër-Fier" dhe nr. 708, datë 21.11.2018, "Për regjistrimin dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë përgjegjëse për Turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Vlorë-Sarandë. Pasuritë e paluajtshme, që ndodhen në zonat në të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, regjistrohen në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit fillestar"-thuhet në vendim. I njëjti shfuqizojnë vendimin e një viti më parë numër 138 datë 23.02.2018 "Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfuturësve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike.

**PEZULLOHET PROCESI NË 12 QYTETE**

1. SHKODËR
2. LEZHË
3. KURBIN
4. DURRËS
5. KAVAJË
6. RROGOZHINË
7. DIVJAKË
8. FIER
9. VLORË
10. HIMARË
11. SARANDË
12. KONISPOL

**DPT/ PENALIZIME**

**Sot afati i fundit i pagesave të kësteve të tatimit mbi fitimin**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka njoftuar tatimpaguesit rreth afatit të fundit të pagesës së kësteve të tatimit mbi fitimin për 3-mujorin e parë të vitit 2019. Sipas njoftimit të DPT, afati i fundit i pagesës së kësteve është data 30 mars, bazuar në nenin 30 të ligjit nr.8438 dt.28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Megjithatë, duke qenë se data 30 mars është ditë pushimi, DPT tha se për të shmangur çdo mbingarkesë të mundshme të sistemit bankar, i kërkoi tatimpaguesve që pagesa e kësteve. DPT njoftoi se në rast mospagimi të detyrimit brenda afateve ligjore, tatimpaguesi do të penalizohet në masën 10% të shumës së këstit për t'u paguar. Sipas dispozitave ligjore, detyrimin e pagesës e kanë tatimpaguesit, të cilët kanë përgjegjësinë tatimore të Tatimit mbi Fitimin.

**Ekzekutohet gjoba ndaj "SGS"**

**Vendimi i AK: Koncesionari do të paguajë 51 milionë lekë**

Autoriteti i Konkurrencës bëri të ditur dje se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë la në fuqi vendimin që gjobiste dhe i vendoste detyrime kompanisë SGS Automotive Albania. Njëkohësisht, autoriteti njoftoi se gjoba prej 51 milionë lekësh është ekzekutuar dhe arkëtuar nga buxheti i shtetit. Në tetor të vitit 2018, Autoriteti i Konkurrencës gjobiti SGS me 5.69% të xhiros së vitit paraardhës, me argumentin se shoqëria ka abuzuar me pozitën e vet monopoliste, duke mos ofruar kapacitete të mjaftueshme për ofrimin e shërbimit. Kjo ka sjellë radhë të gjata për drejtuesit e mjeteve, sidomos në periudha të veçanta të vitit. Sipas arsyesitimit të vendimit, koncesionari nuk ka vënë asnjëherë në përdorim qendrat e kontrollit teknik të lëvizshëm, as në periudhat e flukseve maksimale, siç është fundi i vitit kalendarik. Gjithashtu, kjo kompani,



në mënyrë arbitrare, i detyronte klientët të nënshkruanin një deklaratë-tip, ku SGS heq dorë nga çdo përgjegjësi që mund t'i shkaktohet mjetit gjatë kontrollit teknik. Megjithëse Autoriteti i Konkurrencës kishte kërkuar ndryshimin e përmbajtjes së deklaratës, kompania SGS nuk e mori në konsideratë rekomandimin dhe vazhdoi t'i detyronte klientët ta nënshkruanin atë, pa asnjë ndryshim. Autoriteti i Konkurrencës e

urdhëroi sërish SGS të ndalonte shkeljen e konkurrencës, përmes formave të mësipërme. Gjithashtu, në vendim i rekomandohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që tregu në fjalë të liberalizohet, duke licencuar edhe operatorët të tjerë për ofrimin e shërbimit. Ndërkohë, për afatin e mbetur të koncesionit, rekomandohet të miratohet një rregullorë për funksionimin dhe monitorimin e këtij koncesioni.



**Banka e Shqipërisë: Rigjallërohet kreditimi**

Statistikat e publikuara nga Banka e Shqipërisë, tregojnë se stoku i kredisë së dhënë për bizneset, individët dhe kompanitë shtetërore arriti në 541.5 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej gati 1% në krahasim me muajin e mëparshëm. Ndikimin kryesor në këtë rritje e ka dhënë rritja e huas në euro për bizneset, por edhe për individët. Huaja e sipërmarrjeve në euro u rrit me gati 2% me bazë mujore, ndryshe nga ajo në lekë po për të njëjtën kategori, që u zgjerua me 0.6% në raport me muajin e mëparshëm. E njëjta tendencë ishte dhe për huatë për individë, ku rritja në euro me bazë mujore ishte 1.4% dhe ajo në lekë me 0.4%. Në fund të muajit shkurt, pesha e kredisë në lekë shënoi një ulje të lehtë, nga 50.4% në 50%, ndryshe nga tendenca e muajve të kaluar kur huaja e dhënë në monedhën vendase po shënonte një tendencë rritëse. Në krahasim me muajin shkurt të një viti më parë, kur Banka e Shqipërisë nisi një strategji për të ulur nivelin e eurozimit në ekonomi, duke i orientuar bankat që të fokusoheshin në huaja në monedhën vendase, pesha e kredisë në lekë ka mbetur pothuajse e pandryshuar.

**FUSHË KRUIJË** - Verdi Morava është në ditën e 26 të grevës së urisë në burgun e Fushë-Krujës. Ai është dënuar për nxitje të urrejtjes dhe si pjesë e një "grupi i xhihadist", me lidhje të forta me ISIS. Verdi Morava pretendon se nuk i miratohet leja shpërblyese. Greva e urisë në ambientet e vuajtjes së dënimit mësohet se është një mënyrë për të kundërshtuar kushtet dhe mënyrën e



## Akuza për lidhje me ISIS, Verdi Morava 26 ditë grevë urie në burgun e Fushë-Krujës

trajtimin brenda në burg. Në lidhje me grevën ka reaguar edhe babai i Moravës, i cili akuzon autoritetet për gjendjen e djalit të tij. Sipas tij, djali i tij po vdes urie. "Kërkoj ndihmë, im bir po vdes. Autoritetet nuk po e vënë ujën në zjarr", - mësohet të jetë

shprehur ai. Verdi Morava akuzohet ndër të tjera se rekrutonte luftëtarë për ISIS. Ai doli para gjykatës në vitin 2016 si financues i celulës së ISIS, ndërsa nuk kurseu akuzat ndaj qeverisë duke thënë se është futur padrejtësisht në "listën e zezë". "Qever-

ia më ka futur në listën e zezë, ndërsa jam konsideruar terrorist pa vendim gjykatë. Jam i pafajshëm dhe po më shkelen të drejtat e mia" - ka thënë Verdi Morava në sallën e gjyqit. Seanca ndaj imamëve të vetëshpallur u zhvillua me dyer të mbyllura dhe nën

masa të rrepta sigurie me 16 nëntor 2016. Në sallë ishin pjesëmarrës përfaqësues të ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vendin tonë, si dhe mbështetës të Imamëve të akuzuar: 9 imamët e vetëshpallur akuzohen për terrorizëm e rekrutim luftëtarësh. Gjykata e Apelit pritet të vendosë sot nëse do lërë në fuqi vendimet e Shkallës së Parë, apo do pranojë kërkesat e tyre për pafajësi.

Korçë, kërcënoi me thikë punonjësën e 'exchange'-it, autori merr 2500 euro dhe 1 mln lekë

**TIRANË/KORÇË**

**P**ronari i një pike këmbimi valutore është grabitur paraditen e djeshme në Tiranë. Mësohet se ngjarja e rëndë ka ndodhur në "Rrugën e Barrikadave", në kohën kur 50-vjeçari Agron Shima po lëvizte me motor. Ai u sulmua me levë dhe thikë nga dy persona, të cilët i kanë marrë një shumë prej 60 mijë dollarësh që i mbante në një çantë. Po dje, një tjetër grabitje u shënua në Korçë, ku një person i maskuar ka hyrë në një pikë Western Union dhe pasi ka kërcënuar me thikë punonjësën, arriti të marrë një shumë të konsiderueshme parash. Pas grabitjes, autori është larguar në këmbë nga vendi i ngjarjes, duke shmangur policinë, e cila mbërriti menjëherë pas njoftimit në sallën operative.

**GRABITJA NË TIRANË**

Burime zyrtare nga policia e kryeqytetit dhe bënë me dije se "rreth orës 09:12, në rrugën e "Barrikadave" shtetasi A.Sh., rreth 50 vjeç (pronar i një pike këmbimi valutore) ka qenë duke lëvizur me motor, ndërkohë që është goditur me mjete të forta nga dy persona duke i marrë një sasi lekësh. Reagimi në kohë i policisë ka bërë të mundur kapjen dhe shoqërimin në komisariat të njërit prej autorëve të dyshuar, ndërkohë që autori tjetër ka arritur të largohet. Shërbimet e policisë janë vënë në ndjekje dhe po punohet për kapjen e tij". Ndërkaq, burime për "GSH" pohuan se dy grabitësit e kanë ndjekur Agron Shimën dhe në momentin që ka dalë nga pika e tij e këmbimit dhe po lëvizte me motor në drejtim të tregut të njohur si "Dollari", ai është goditur në kokë dhe trup me levë dhe thikë në bark duke humbur kontrollin e motorit dhe rëzuar në tokë. Në moment dy agresorët i kanë marrë çantën ku kishte 60 mijë dollarë dhe kanë tentuar që të arratisin. Vetëm njëri ka arritur të largohet bashkë me paratë, ndërsa tjetri ka përfunduar në pranga. Autorët, të pamaskuar, por me skafandra në kokë për të mos u identifikuar hipën në motor për t'u larguar me shpejtësi, por në këtë moment ndërhyri me shpejtësi një efektiv i policisë rrugore. Blutë kanë shpallur në kërkim grabitësin që mori arratinë dhe

# Sulmohet me levë e thikë kambisti në Tiranë, arrestohet njëri nga autorët, tjetri në kërkim

*Dy agresorët i morën 50-vjeçarit Agron Shima 60 mijë dollarë që i kishte në çantë*



Grabitja e kambistit në Tiranë, arrestimi i njërit prej autorëve



Grabitja në Korçë

po punojnë në intensivisht për kapjen e tij.

**GRABITJA NË KORÇË**

Një pikë Western Union është grabitur mëngjesin e djeshëm në qytetin e Korçës. Sipas burimeve policore, një person i maskuar dhe me thikë në dorë ka hyrë në pikën e këmbimit valutore dhe të transfertave të parave në orën 9:00 dhe ka kërcënuar punonjësën. Ngjarja ka ndodhur në lagjen nr.10 të qytetit të këtij qyteti. Nën kërcënimin e thikës, autori dyshohet se ka marrë një shumë parash, rreth 2500 euro dhe 1 mln lekë të vjetra. Policia ka mbërritur menjëherë në vendin e ngjarjes, por pa mundur të kapë autorin e krimin. Pasi ka marrë shumën e eurove ai është larguar me shpejtësi duke humbur gjurmët, ndërsa policia ka ngritur disa postbllaqe në qytetin juglindor, por pa mundur ta vërë në pranga. Grupi hetimor po punon intensivisht për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe arrestimin e autorit.

**TIRANË** - Prokurori Ardian Nezha, i cili kërkoi dënim me burg përjetë për Dritan Dajtin, ka dhënë dorëheqjen e parevokueshme. Ish-drejtuari i prokurorisë së Elbasanit, ka paraqitur dje dorëheqjen pranë KLP-së. Ndërkaq, Nezha ka sqaruar për "News 24" arsyet e dorëheqjes. Ai është shprehur se ndaj tij ka pasur mungesë vlerësimi. Ardian Nezha ka kërkuar nga KLP t'i pranohet dorëheqjen duke shpallur përfundimin e statusit të magistratit, ndërsa kërkesa e tij pritet të shqyrtohet më 1 prill. Në vitin 2015, Ardian Nezha nga prokuror pranë Prokurorisë për Krime të Rënda u transferua prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë. Nezha ka pasur në hetim dosjet të rëndësishme, një prej të cilave është ajo e "Bandës së tritolit". Ndërkohë, Prokuroria e Përgjithshme ka argumentuar se lëvizja është e detyruar nga

## Kërkesa drejtuar KLP-së pritet të shqyrtohet më 1 prill

### Dorëhiqet prokurori i dosjes së Dritan Dajtit dhe i "bandës së tritolit", Ardian Nezha



mungesa e kapaciteteve njerëzore në ato prokurori, ku ka nevojë me shumë për hetim të shpejtë dhe efikasitet. Me emërimin e kryeprokurores së Përgjithshme të Përkohshme Arta Marku, më 9 janar

2018, ai u emërua në krye të Prokurorisë së Elbasanit në vend të Dritan Ginës. Gjatë drejtimit të kësaj prokurorie, Nezha ka kryer disa operacione, siç janë rasti i arrestimit të zyrtarëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, arrestimi i grupit të tritolit e të tjerë. Ndër vite, Nezha ka pasur në hetim dosjet të rëndësishme, ku një prej të cilave është ajo e "bandës së tritolit". Por vetëm pak kohë pasi kishte marrë këtë detyrë, Nezha dha dorëheqjen. Arsyet e dorëheqjes mbetën mister, dhe versionet ishin nga më të ndryshmet. Në media u raportua se Nezha e mori vendimin për shkaqe shëndetësore. Një tjetër version që u lakua ishte se vendimi për

dorëheqjen ishte një lëvizje taktike, për të ardhur drejt Tiranës, për një post më të rëndësishëm. Dhe, në fakt, versioni i dytë thuajse ka baza për të qenë më i besueshëm. Besueshmërinë e konfirmoi vetë kryeprokuroroja Arta Marku, me emërimin e fundit të Nezhës. Një javë pasi dha dorëheqjen dhe konkretisht në fillim të muajit prill 2018, ish-kreu i Prokurorisë së Elbasanit, Ardian Nezha, u komandua prokuror në Tiranë, në sektorin e veprave penale kundër jetës. Por së fundmi, prej pak javësh ai ishte rikthyer prokuror në Pukë, ndërsa pas këtij veprimi ka kërkuar të largohet nga sistemi çka do të sillte edhe ndërprerjen e vetingut për të.



**Procedohen 14 persona të tjerë dhe 6 në kërkim**

**Protesta e opozitës, policia: 7 të arrestuar, procedim për sekretarin e PD-së, Gazment Bardhi**

**TIRANË** - Policia e Tiranës ka proceduar 28 persona të akuzuar për akte dhune në protestën e së enjtes, të organizuar nga opozita e bashkuar. Mësohet se blutë e kryeqytetit, nën drejtimin e prokurorisë së këtij rrethi kanë arrestuar 7 shtetas, për veprimet të dhunshme mbi institucionet kushtetuese, mbi policinë dhe për shkatërrimin e pronës gjatë zhvillimit të protestës së Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për In-

tegrim para parlamentit. Veprimet procedurale janë kryer në bazë të një analize të pamjeve filmike, raport shërbimeve, si dhe provave të tjera të mbledhura nga grupi hetimor. Janë proceduar në gjendje të lirë dhe 14 persona të tjerë, ndërta 6 shtetas janë shpallur në kërkim. Gjithashtu, është proceduar penalisht edhe sekretari i përgjithshëm i PD-së, Gazment Bardhi, organizator i protestës së zhvilluar dy ditë më parë. Ky është një tjetër procedim

për Bardhin, pas protestave të kaluara. Policia thotë se janë prangosur për konsumimin e elementeve të veprave penale: "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", "Goditje për shkak të detyrës", "Prishja e qetësisë publike" dhe "Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse, djegëse dhe radioaktive" shtetasit: Agim Sallaku, 49 vjeç, banues në Tiranë; Olsi Kasemi, 20 vjeç, banues Tiranë; Luis Buzheri, 22 vjeç, banues Tiranë; Maringlen Meçja, 22



Protesta e opozitës

vjeç, banues ne Elbasan; Aleksandër Prenga, 23 vjeç, banues në Tiranë; Gjok Drezhaj, 46 vjeç, banues në Malësi të Madhe; Shefqet Sefaj, 45 vjeç, banues në Tiranë. Sipas policisë, punohet për identifikimin, kapjen dhe vënien

para përgjegjësisë ligjore të personave të tjerë që kanë kryer veprime të dhunshme gjatë protestës së djeshme. Materialet procedurale do t'i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprime të mëtejshme.

**Krimet e Rënda "kthejnë" në shtëpi Emrah Plakun, anëtar i grupit "Bajri"**

**TIRANË** - Gjykata për Krime të Rënda ndryshoi dje masën e sigurisë për Emrah Plakun, një prej të dyshuarve si pjesë e bandës kriminale të drejtuar nga Safet dhe Enver Bajri. Nga arrest me burg, trupi gjykoes vendosi ndaj Plakut arrest shtëpie. Gjyqtari Klodian Kurushi urdhëroi që i dyshuari të mos largohet nga banesa e tij në Shkodër, qytet ku ushtron aktivitetin banda kriminale dhe të mos komunikojë me persona të tjerë përveç familjarëve, bashkëjetueses dhe avokatit mbrojtës. Gjykata ka urdhëruar policinë e Shkodrës të zbatojë dhe mbikëqyrë në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë masën e sigurisë caktuar ndaj Plakut, ndaj të cilit rëndojnë dyshimet për mbajtje pa leje të armëve luftarakë dhe municionit. Ky vendim erdhi për faktin se masa e sigurisë arrest me burg, e caktuar ndaj të akuzuarit e kishte humbur efektin, pasi kishte kaluar çdo afat ligjor. Për këtë shkak, avokati Arbër Hoxhaj këmbënguli për lehtësimin e masës së sigurisë për të mbrojturin prej tij, duke ia dalë mbanë ta bindte gjykatën. Emrah Plaku u arrestua gjatë operacionit të zhvilluar më 6 shtator të vitit të kaluar në Shkodër. Fillimisht gjykata e Shkodrës caktoi ndaj tij masën e arrestit me burg, masë që më vonë u konfirmua nga Krimet e Rënda. Më herët, gjykata ka liruar nga qelitë e paraburgimit të tjerë të dyshuar të bandës "Bajri", duke shfryrë në këtë mënyrë dhe bujën e superaksionit, që u trumbetua vjeshën e kaluar si një goditje e madhe e "Forcës së Ligjit".

Policia: Nuk përjashtohet mundësia që vrasja të ketë ndodhur pas një sherri banal

**Ekzekutimi i ish-menaxherit të VIP-ve, Jurgen Kurtit, zbulohen 2 pistat e hetimit**  
*Ngjarja dyshohet të ketë marrë shkas për hakmarrje*

**TIRANË**

**P**ak ditë pas atentatit ku u ekzekutua ish-menaxheri i VIP-ve, Jurgen Kurti, policia vuri në pranga tre persona, ndërta shpall në kërkim 38-vjeçarin nga Patosi, Klodian Bane (Buxhaku), i cili është i dyshuari kryesor për vrasjen. Bane është në kërkim nga policia, ndërta emri i tij u zbulua nga njëri prej tre personave që u arrestuan si bashkëpunëtorë. 22-vjeçari Olsi Qalliaj po nga Patosi ishte personi që përmendi për herë të parë emrin e Klodian Banes dhe që e orientoi policinë drejt dyshimeve të forta se ky i fundit është personi që ekzekutoi Jurgen Kurtin. Katër ditë para ekzekutimit të Jurgen Kurtit, Qalliaj e takoi Klodian Bane dhe i mori çelësin për të fjetur në apartamentin e tij. Ndonëse blutë arritën të zbardhnin dinamikën e ngjarjes së rëndë të ndodhur mbremënjën e 18 marsit në rrugën "Zef Jubani", ende mbetet i paqartë motivi i krimit që tronditi banorët e kryeqytetit dhe jo vetëm. Sipas "Opinion", pista kryesore e policisë për vrasjen e Kurtit është ajo e hakmarrjes, por krahas kësaj piste është edhe ajo e një sherri banal, pasi të dyshuarit merreshin edhe me tregtimin e automjeteve. Deri më tani asnjëri prej tre të arrestuarve nuk e ka pranuar krimin.

**DINAMIKA E NGJARJES**

Pas ekzekutimit të 26-vjeçarit Jurgen Kurti, hetuesit u varën në ndjekje të një makine tip "Mercedes Benz E Clas", ngjyrë gri, e cila u për-



Vendi ku u ekzekutua Jurgen Kurti



38-vjeçari i shpallur në kërkim, Klodian Bane

**PROVAT**

Pamjet e kamerave të sigurisë si dhe disa mesazhe telefonike janë provat e para të forta që implikojnë në krim të arrestuarit Olsi Qalliaj, Elsi Levendi dhe Alesio Berberi dhe të shumëkërkuarin Klodian Bane (Buxhaku). Në dosjen hetimore të siguruar nga "Gazeta Shqiptare", zbardhen të gjitha lëvizjet e të dyshuarve para dhe pas ngjarjes dhe provat që i implikojnë në krim, ndërta nuk del i qartë motivi se përse është ekzekutuar Kurti dhe kush ishte porositi, pasi dyshimet janë për një vrasje me pagesë. Ndërkaq, ditën e djeshme, Gjykata e Tiranës la në "Arrest me burg" tre të arrestuarit për vrasjen e Jurgen Kurtit.

dor nga autorët për t'u larguar nga vendngjarja. Kamerrat e sigurisë në zonë kishin fiksuar makinën në fjalë, e cila kishte disa karakteristika dalluese. Kishte një antenë në pjesën qendrore të xhamit të pasmë dhe kur frenonte, drita e frenës tregjonte pjesa e bagazhit nuk ndizej e plotë. Dyshimet janë shtuar për faktin se automjeti është fokusuar për herë të parë rreth orës 20:00, teksa hyn kundravajtje pikërisht në vendin ku dy orë më vonë u vra Kurti dhe bën tri xhiro. Nga aty, del tek posta nr8, më pas në rrugën "Sulejman Delvina". Targa e mjetit rezultonte e vjedhur. Referuar pamjeve, automje-

ti që më vonë rezultoi të ishte në pronësi të Klodian Banes shkon te vendi i ngjarjes dhe ndalon për rreth një orë. Drejtuesi del disa herë dhe shfaqet teksa fotografon shkallën e pallatit të Jurgen Kurtit. Elsi Levendi ndërta dallohet që vjen nga posta dhe ulet te kafa ngjitur me hyrjen e një palestrest, në të cilën ndodhej Kurti. Katër orë më parë, ai kishte marrë porosi me mesazh që të mbante nën vëzhgim Jurgen Kurtin. "Kalo pak te lagja mbrapa postës dhe shiko Jurgen Kurtin. Më thuaj nëse e sheh këtë person". Levendi shkruan se nuk e njihje personin, por i ka ardhur sërish një mesazh tjetër, "vetëm rri

aty, nëse e shikon më njofto". Në momentin kur Jurgen Kurti ka dalë nga palestra, Levendi shkruan: "Doli një person, por nuk jam i sigurt nëse është Jurgen Kurti". "Është një djalë i gjatë, i bëshëm", i përgjigjet mesazhshkruar. Momentet kur Levendi shkëmben mesazhet janë fiksuar nga kamerrat. Fill më pas vritet Kurti. Edhe ekzekutimi i të riut është filmuar. Nga këqyrja rezulton se prej "Benz"-it del një person dhe pasi merr diçka në dorë, bën veprime të njëjta me ato të qitjes me armë. "Benz"-i fillon lëvizjen drejt ish-lokal "Shushicës" e më vonë konstatohet te Kopshti Zoologjik. Ndërkaq, Levendi

del përpara postës dhe merr një taksit e nisat drejt digës së Liqenit. Aty ndalon për të blerë një paketë cigare. Rikthehet në makinë dhe më vonë shfaqet në afërsi të Liqenit të Thatë. Aty ngjitet në automjetin tip "Benz". Pranë "Benz"-it mbërrin dhe një automjet tip "Audi" në pronësi të Olsi Qalliaj, që shfaqej në kamera pranë vendit të ngjarjes. Pasi bëhen bashkë të rinjtë, njëri prej tyre shkaputet me një qese dhe shkon drejt Liqenit të Thatë, ndërta dy të tjerët ikin në drejtim të pallateve. Të tre dalin 25 minuta më vonë. Njëri ikën me "Audi", tjetri shkon merr qesen, ndërta i treti kthehet në shtëpi. Të nesërmen ata lëvizin "Benz"-in, ndalojnë fillimisht në një market në zonë, e më pas fillojnë lëvizjen normale. Në ndihmë të policisë erdhën sërish kamerrat, që fiksuat targën e makinës, e cila rezultoi në pronësi në Klodian Banes. Në këtë mënyrë u ra në gjurmë të personave të dyshuar, për tre prej të cilëve gjykata caktoi masën e "Arrestit me burg".

**Shpërndante kokainë në lokale, bie në pranga 23-vjeçari**

**TIRANË** - Një 23 vjeçar, i cili ishte nën vëzhgim prej kohësh, ka rënë në pranga e policisë së Tiranës për trafikim të lëndëve narkotike. Mësohet se të riut me iniciale G.X., banues në kryeqytet i janë sekuestruar 19 doza kokainë, peshore elektronike, automjet dhe aparat celular. Shërbimet e policisë e kanë konstatuar këtë shtetas duke qarkulluar me mjet në aksin rrugor "Elbasan-Tiranë" dhe e kanë ndaluar për kontroll. Nga kontrolli i ushtruar në mjet u gjetën 3 doza kokainë. Gjithashtu, është ushtruar kontroll edhe në banesën e këtij shtetasi, ku në pjesën e kompjuterit u gjetën të fshehura 16 doza kokainë. Sipas bluve, i riu shpërndante drogë në lokale e Tiranës.



Dje gjatë aktivitetit të 'Luarasi'

Sokol Vladi: Ndiqni ëndrrat tuaja! Zv.rektorja Sharko: Fjalime inspiruese

# Eventi "DigiGirlyz Albania" i Microsoft vjen në universitetin "Luarasi"

Programi: Përfshirja e vajzave në fushën e teknologjisë

Voltiza Duro

Teknologjia e informacionit po bëhet pjesë e pandarë e jetës së përditshme, e madje një nga fushat më të suksesshme në tregun e punës. Por për shkak të paragjykimëve të ndryshme, përfshirja e vajzave në shkencat kompjuterike nuk është fort e shpëhapur, e kjo jo vetëm në Shqipëri. Për të frenuar këto stereotipe, në ambientet e universitetit "Luarasi" maturante nga shkolla të mesme të ndryshme u bënë pjesë e eventit të Microsoft, "DigiGirlyz Albania". Teknologjia e informacionit ofron dimensione të pafundme për të rinjtë që dëshirojnë të bëhen pjesë e kësaj bote. Drejtori i Përgjithshëm i Microsoft Albania, Sokol Vladi tha se TIK ofron një të ardhme të ndritur për të rinjtë. "Ashtu si në të gjithë botën, Microsoft e zhvillon DigiGirlyz me misionin për të inkurajuar vajzat për të ndjekur shkencat kompjuterike si një ndër industritë në të cilat kanë një të ardhme më të ndritur. Besoj që teknologjia e informacionit është tanimë gjithnjë e më shumë prezent tek secili në të gjitha industritë dhe potenciali për të pasur një të ardhme në karrierë në fushën e TIK apo digjitalizimit është shumë e madhe. Përveç kësaj edhe industria vetë ka nevojë me të gjitha zhvillimet që po përjetojnë dhe përmirësimet e mëtejshme do të kërkojnë inspirimin që vajzat sjellin në industri dhe prandaj kjo është një ndër gjërat që duhet inkurajuar gjithnjë e më shumë", tha Vladi. Ky i fundit më tej iu sugjeroi të gjithë vajzave të apasjuara pas kësaj industrie që të ndjekin ëndrrat për një të ardhme profesionale të sigurt. "E ardhmja është e ndritur dhe dimensionet me të cilat të rinjtë dhe të rejtat do të mund të zhvillojnë veten e tyre dhe po mendon të shkojë në universitet, të shqyrtojë mundësinë dhe të dashurojë shkencat kompjuterike, si një ndër gjërat që mund t'u japë mundësinë për të zhvilluar sa më mirë", - tha drejtori i Microsoft.



Eventi "DigiGirlyz Albania" i Microsoft



inë të ndjekin fjalime inspiruese nga ekspertët më të mirë të fushës së teknologjisë. "Nxënëset pjesëmarrëse do të kenë mundësi të jenë pjesë e fjalimeve inspiruese nga përfaqësues të Microsoftit, nga përfaqësues të "Luarasit", nga përfaqësues të ekspertizës më të mirë të presidentes dhe inxhinieres Microsoft, me eksperiencë në Britaninë e Madhe. Në fund fare do të ketë një event që do të jetë pjesë e workshopit, ku bashkëngjitur me teknologjitë më inovative, duke arritur të ndërtojnë check bootin e tyre përafërsisht në 30 minuta. Universiteti "Luarasi" është promotor në idetë inovative, bazuar në fakultetin e tij të ri, atë të teknologjisë së informacionit dhe inovacionit. Do të jemi mbështetje jo vetëm e gjimnazistëve, por e të gjithë maturantëve, të cilët do të ketë qasje në teknologjinë e informacionit, si vajzat që kanë prioritet tek ne, por dhe djemtë. Pra, sa më shumë inovative të jenë idetë e tyre, aq më pranë tyre do të jemi ne gjithë këtë periudhë, derisa ato të jenë pjesë e universiteteve, qoftë shtetërore apo private", u shpreh zv.rektorja e "Luarasit". DigiGirlyz është një event teknologjie dedikuar vajzave, pjesë e një programi Microsoft YouthSpark. Maturantet pjesëmarrëse, u bënë pjesë e një workshop-i mbi teknologjitë më të fundit inovative, duke arritur të ndërtojnë ChatBOT-in e tyre të parë, për 30 minuta.

### SOKOL VLADI: ZGJIDHNI TEKNOLOGJINË

"E ardhmja është e ndritur dhe dimensionet me të cilat të rinjtë dhe të rejtat do të mund të zhvillojnë veten e tyre dhe po mendon të shkojë në universitet, të shqyrtojë mundësinë dhe të dashurojë shkencat kompjuterike, si një ndër gjërat që mund t'u japë mundësinë për të zhvilluar sa më mirë", - tha drejtori i Microsoft.



### ANNI DASHO SHARKO: "LUARASI", PROMOTOR IDESH

"Universiteti 'Luarasi' është promotor në idetë inovative, bazuar në fakultetin e tij të ri, atë të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit. Do të jemi mbështetje jo vetëm e gjimnazistëve, por e të gjithë maturantëve, të cilët do të ketë qasje në teknologjinë e informacionit, si vajzat që kanë prioritet tek ne, por edhe djemtë", - tha Sharko.



mund t'u japë mundësinë për të t'u zhvilluar sa më mirë", - tha drejtori i Microsoft.

### MUNDËSITË

Zv rektorja e universitetit Luarasi, Anni Dasho Sharko tha se ky program i Microsoft është ideuar që të ndërtojë një karrierë të suksesshme në fushën e shkencave kompjuterike. "DigiGirlyz" albania është një aktivitet i zhvilluar në bashkëpunim me Microsoft në bashkëpunim me "Luarasin", Universitetin Politeknik të Tiranës dhe City University. DigiGirls është një event teknologjie dedikuar gjithë vajzave gjimnaziste që do të jenë pjesë e këtij programi, i cili është konceptuar për të ndërtuar një karrierë të suksesshme në fushën e teknologjisë së informacionit", tha ajo. Sharko shtoi se tha se nxënëset pjesëmarrëse në këtë event do të kenë mundësi-

vendin ku ndodhen janë të pafundme për vetë faktin se teknologjia sot është thjeshtuar në atë masë ku gjithkush mund të provojë, mund të fan-

tazojë dhe të sjellë në komunitet në çdo lloj dimensionimi më të mirat që teknologjia mund të prodhojë. Kjo është një ndër këshillat për çdo vajzë që

po mendon të shkojë në universitet. Të mundet të shqyrtojë mundësinë dhe të dashurojë shkencat kompjuterike si një ndër gjërat që

**SHPLLJE ANKANDI**

Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me përbarime gjyqësore Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 25.04.2019 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shlyer e pasurisë së paluajtshme, Apartament me sipërfaqe totale 86.35 m<sup>2</sup>, me numër pasurie 2/139/ND+1-13, volumni 71, faqe 142, zona kadastrale 8518, me adresë Lagja 13, Plazh, Hyja 1, Ap.13 Durrës, në pronësi të Z.Cilrim Sejfulla Xhafa dhe Znj.Bardha Xhamat Xhafa me vlerë fillestare në ankand 20.454.84 (Njëzet mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e katër) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580,+355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k**  
Rr. "Tish Dasi", Kompleksi Koka 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë  
Web: www.3h.sh Email: shg@3hsh.com tel:0692028711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.26.03.2019 deri ne dt. 04.04.2019 per: sendin e luajtshem mjeti me targe DR 9619 D ne pronesi te Hysni Gjergji

Cmimi fillestar eshte 560 EURO

Ankandi zhvillohet ne zryren perbarimore ne daten 04.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbarime Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dytë për pasurinë :  
1- Njesi", me sipërfaqe 64.10 m<sup>2</sup> , e ndodhur në Lagja Bankade, Berat, në Zonën Kadastrale 8501, Numri i Pasurisë: 8/147-N1, Vol. 22, Fage. 87, ne pronesi te Dorjana Gjoroveni,Endri Gjoroveni,Beshir Gjoroveni. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 4,953,848 (kater milion e nentëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e tet) LEKE.

Ankandi i dytë për pasurinë e mesiperme zhvillohet me datë 19.04.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbarimeve gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Mystym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .



"Autoritetet kontraktuese të nisin procedurat e prokurimit publik brenda prillit"

Voltiza Duro

# Vendimi i qeverisë: 33 shkolla të parauniversitarit, rikonstruktiv në 2020-ën

## Financimi, rreth 2.4 miliardë lekë për projektet e reja

Plot 33 shkolla të parauniversitarit në të gjithë vendin, do t'i nënshtrohen rikonstruktimit brenda vitit 2020 me një financim rreth 2.4 miliardë lekë. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e plotë të shkollave që do t'i nënshtrohen rikonstruksioneve si dhe financimin e përcaktuar për secilën prej tyre. Ditën e djeshme, Këshilli i Ministrave vendosi shpërndarjen e financimit për projektet e reja, thirrja e parë për vitin 2019, për grantet "Arsimi bazë", "Arsimi i mesëm" dhe "Arsimi i lartë", brenda një jave nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare, duhet të

paraqesin në sekretariat teknik, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit, si dhe të përdorimit të fondëve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik", thuhet në vendim.

Nënkohë, autoritetet kontraktuese për projektet, duhet të nisin procedurat e prokurimit publik brenda një muaji pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Për fondet e projekteve të pa prokuruar

sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtë të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato për një thirrje tjetër/projekte të tjera.

VLERAT E FINANCIMIT PER 33 SHKOLLA NE VEND

Tabela 1. Lista e projekteve të reja, thirrja e parë për vitin 2019, grantet "Arsimi bazë", "Arsimi i mesëm", me cikël zbatim 2019-2020

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit nga FZHR për vitin 2019 (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV (në lekë)		%	Vlera e plotë e bashkëfinancimit (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2019 (në lekë)					
<b>QARKU BERAT</b>														
1	Bashkia Kuçovë	Rikonstruksion i shkollës "18 Tetori", Kuçovë	76,911,627	21,535,256	30	23,073,488	13,036,744							
2	Bashkia Ura Vajgurore	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Abdi Shehu", Samaticë	57,327,077	20,637,748	10	5,732,708	5,732,708							
<b>QARKU DIBËR</b>														
3	Bashkia Klos	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Shaban Gjallica"	89,342,071	28,142,752	10	8,934,207	8,934,207							
<b>QARKU KUKËS</b>														
4	Bashkia Tropojë	Shkolla Asim Vokshi-Palestër dhe terrene sportive dhe sisteme të jashtme në gjimnazin "Asim Vokshi"	59,919,542	21,571,035	10	5,991,954	8,987,931							
5	Bashkia Tropojë	Rikonstruksion i shkollës "Tirka Kurti", Lekëbaj	29,488,437	13,269,797	10	2,948,844	4,423,266							
6	Bashkia Kakës	Ndërtim i terreneve sportive të shkollës Shtegën	15,590,893	5,456,813	30	4,677,268	2,338,634							
<b>QARKU DURRËS</b>														
7	Bashkia Shijak	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "Adem Sabli", fshati Borakë	73,231,332	19,772,460	10	7,323,133	10,984,700							
8	Bashkia Knajë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare dhe ndërtim palestere, Thumanë	70,671,320	19,787,970	30	21,201,396	11,350,698							
<b>QARKU ELBASAN</b>														
9	Bashkia Elbasan	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Jongji Dilo", Elbasan	124,187,521	21,732,816	50	62,093,761	31,046,880							
10	Bashkia Belsh	Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri, Belsh	89,987,967	28,346,210	10	8,998,797	8,998,797							
11	Bashkia Peqin	Rikonstruksion dhe ndërtim palestere shkolla e mesme "Mustafa Kemal Atatürk", Pajovë	58,666,068	21,119,784	10	5,866,607	5,866,607							
12	Bashkia Librazhd	Shtesë anësore 3 kate dhe ndërtim palestere për shkollën 9-vjeçare "Wilson Bllodhna", Librazhd	82,881,472	26,107,664	10	8,288,147	7,288,147							
<b>QARKU FIER</b>														
13	Bashkia Lushnjë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "4 Dëshmorët", Lushnjë	49,881,342	9,976,268	50	24,940,671	12,470,336							
14	Bashkia Lushnjë	Rikonstruksion i ambienteve të shkollës së bashkuar "Thanas Bozo" dhe ndërtim palestere, Kolorjë	78,525,669	15,705,134	50	39,262,835	19,631,417							
15	Bashkia Roskovec	Rikonstruksion godine dhe ndërtim palestere gjimnazi "Adem Vrepi"	99,120,026	31,222,808	10	9,912,003	11,412,003							
16	Bashkia Divjakë	Rikonstruksion dhe shtesë anësore 2 kate, i shkollës së mesme të bashkuar, "Rifat Ndozi", Fshat Vajgurore	81,681,368	20,011,935	30	24,504,410	12,252,205							
17	Bashkia Divjakë	Ndërtim kopshti me drekë në Cerme, Sektor	67,261,984	16,479,186	30	20,178,595	10,089,298							
18	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Jovan Ndreko", Libofshë	26,241,404	6,560,351	50	13,120,702	6,560,351							
19	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Penelopi", Fier	41,793,855	8,358,771	50	20,896,928	10,448,464							
20	Bashkia Patos	Rikonstruksion i shkollës "Mustafa Matohini"	88,610,769	27,912,392	10	8,861,077	8,861,077							
<b>QARKU KORÇË</b>														
21	Bashkia Pogradec	Rehabilitim i shkollës së mesme "Gjergj Pekmezi"	77,497,937	18,986,995	30	23,249,381	11,624,691							
22	Bashkia Pustec	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar, Pustec	27,097,398	12,193,829	10	2,709,740	2,709,740							
23	Bashkia Kolonjë	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Petro Nini Luarasi", Ersekë	71,447,880	22,506,082	10	7,144,788	7,144,788							
24	Bashkia Korçë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, "Nuçi Naci". 3 kate shtesë për palestër	50,000,000	14,000,000	30	15,000,000	7,500,000							
<b>QARKU LEZHË</b>														
25	Bashkia Kurbini	Rikonstruksion i plotë i shkollës 9-vjeçare "Mark Trothi"	97,639,380	27,339,026	30	29,291,814	16,145,907							
26	Bashkia Lezhë	Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar, "Ishull Lezhë" dhe ndërtim palestere	81,170,727	14,204,877	50	40,585,364	20,292,682							
27	Bashkia Mirditë	Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinave 1, 2, 3, shkolla "Vaso Pasha", Rrëshen	122,093,419	36,917,510	10	12,209,342	12,209,342							
28	Bashkia Mirditë	Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemin ambiant, shkolla e mesme e bashkuar "Ndreç N. Gjoka", Fan	72,172,645	25,982,152	10	7,217,265	7,217,265							
<b>QARKU SHKODËR</b>														
29	Bashkia Malësi e Madhe	Rikonstruksion i shkollës "Vasil Shanto", fshati Vrakë	42,194,347	11,814,417	30	12,658,304	4,219,435							
30	Bashkia Fushë Arrëz	Ndërtim i palestres dhe ambienteve sportive, shkolla e mesme "70-vjetori i Pavarësisë"	49,554,052	22,299,323	10	4,955,405	5,955,405							
<b>QARKU TIRANË</b>														
31	Bashkia Kavajë	Rindërtim i shkollës 9-vjeçare Golem, Kavajë	142,515,637	39,904,378	30	42,754,691	21,377,346							
32	Bashkia Vorë	Rikonstruksion i plotë dhe shtesë e shkollës "Vajdin Lama", Domje	88,717,281	22,525,730	30	26,615,184	13,307,592							
<b>QARKU VLORË</b>														
33	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i shkollës "24 Maji" dhe ambienteve sportive, Vlorë	99,578,242	19,915,648	50	49,789,121	24,894,561							
<b>TOTALI</b>			<b>2,383,000,689</b>	<b>672,297,118</b>	<b>830</b>	<b>600,987,930</b>	<b>365,313,224</b>							

VEPRA

# Driant Zeneli

## Fëmijët e minierave të Bulqizës, në Bienalen e Venecias

Fatmira Nikolli

*Vepra e artistit shqiptar përfshin Metalurgjikun e Elbasanit dhe Bulqizën*

Ndodhemi në Bulqizë pranë minierave dhe kemi për ballë 5 heronj. Janë pesë fëmijë që ecin nëpër zonën e minierës, ndërtojnë një kapsulë kozmike dhe duan të ikën prej aty. "Vepra flet për 5 astronautë të vegjël që gjejnë një kapsulë kozmike dhe nisin udhëtimin e tyre. Udhëtimi i tyre ndiqet nga një person i gjashtë". Artisti Driant Zeneli e shpjegon kështu këtë pjesë të veprës me të cilën Shqipëria shkon në Bienalen e Venecias. A është përfshirë në të drama sociale e fëmijëve të Bulqizës? A është përfshirë drama e një qyteti si Bulqiza apo drama e një qyteti si Elbasani me ndotjen e madhe për shkak të Metalurgjikut? A i prek vepra problemet tona?

I pyetur nga "GSh" Dritani tha se përballë tragjedisë së të tjerëve secili ndjehet ndryshe. "Edhe në revista ke në një krah tragjedinë dhe në anën tjetër është reklama. Disa prej nesh e shohin. Jam shumë i interesuar për aspektet sociale e politike. Krijoj narrativë paralele duke luajtur mes reales e fiksonit. Ka momente që biem e që ngrihemi.

Kjo s'do të thotë që vepra nuk prek. Kjo s'do të thotë që s'po flas për situatë sociale. Por edhe si mund të ripërdoret situata sociale dhe si mund të ripërdoret metalurgjiku", tha ai.

Ndërsa kuratorja Alicia Knock tha se Dritani ndërton triologji. "Idea si gjëja lokale bëhet globale. Është e bukur të punosh me një projekt me këtë titull dhe kthesë në një kohë që Shqipëria s'mund të shihte disa gjëra dhe ishte e mbyllur". Sa i takon anës sociale ajo tha se "nuk duhet të mohosh kaosin. Ne mund të fluturojmë. Ne mund ta provojmë. Ajo që ndjehet është se ky projekt është shumë fikcional, tragjik dhe pothuaj pesimist", tha ajo duke folur për fëmijët e Bulqizës, që duan të udhëtojnë e të ikën. Konkret tha se ky udhëtim në hapësirë për ata fëmijë që s'mund të lëvizin tokën jo më kozmosin. Duke folur për veprën e Zenelit ministrja Elva Margariti tha se ai është një artist që ka marrë shumë çmime ndërkombëtare dhe që na ka

nderuar. "Drianti ka gjetur hapësira në disa qytete të botës.

Çmimet që ka fituar e kanë bërë një figurë që na mirëpërfaqëson".

Margariti përmendi ekspozitat e Zenelit nëpër botë".

### VEPRA

Pavijoni shqiptar në Bienalen e Venecias i takon Driant Zenelit me titullin: Maybe the cosmos is not so extraordinary. Këtë vit pavijoni qëndron hapur në datat 11 maj - 24 nëntor 2019. "Ndoshta kozmosi nuk është aq i jashtëzakonshëm", një projekt i artistit

tetit dhe kontrollit. Maybe the cosmos is not so extraordinary (2019) është një video-instalacion skulpturor, i cili bazohet në një projekt shumëdisiplinar emërtuar Beneath a surface there is just another surface, i cili nisi në vitin 2015 në Metalurgjik, një kompleks industrial dystopian, në qytetin e Elbasanit në

Shqipëri. Projekti dhe titulli i tij rrjedhin nga novela fanastikoshkencore "Drejt Epsilonit të Eridanit" (1983) e shkruar nga fizikani dhe shkrimtari shqiptar



Artisti Driant Zeneli

në minierat e Bulqizës, një qytet në verilindje të vendit, ku, që prej vitit 1918, është nxjerrë minerali i kromit.

Kromi përbën një burim kryesor për zhvillimin industrial të Shqipërisë dhe bie ndesh me përplasjet ekonomike dhe politike në Jugun Global (botën në zhvillim). Filmi paraqet një grup adoleshentësh nga Bulqiza që zbulojnë një kapsulë kozmike, e cila ndjek udhëtimin e kromit, nga nxjerrja dhe

përpunimi i tij brenda fabrikës deri në eksportimin dhe shfrytëzimin e tij në mbarë botën. Prandaj, ky udhëtim hapësinor "gjeopolitik" e kthen këtë mjedis in-

rrëfimit binar, koreografisë së përpiktë të pamjes dhe zërit, fabrika mbarëvepron jo vetëm si një hapësirë industriale apo qendër gjeopolitike, por edhe si një forcë pamore performuese. Nxjerrja e kromit shndërrohet në një pamje skulpturore hipnotike dhe, si pasojë, e tërë fabrika përkthehet në një instalacion të madh "paralel" të dritës dhe zërit, i vulosur organikisht në muret e Arsenales. Në këtë hapësirë produktive dhe magjepsëse, Driant Zeneli synon të krijojë tension midis një realiteti shtypës nëntokësor dhe një hapësire utopike të mundësisë dhe çlirimit. Maybe the cosmos is not so extraordinary përpiktë të zbulojë fizikisht aftësinë e së zakonshmes, madje edhe në qoshtet e saj më të errëta, për të zgjeruar qenien tonë.

Driant Zeneli (1983, Shkodër, Shqipëri) jeton dhe punon mes Tiranës dhe Milanos. Në vitin 2008 fitoi çmimin ndërkombëtar të artit bashkëkohor "Onufri", në Tiranë; në vitin 2009 çmimin e artistëve të rinj europianë "Trieste Contemporanea" dhe në vitin 2017 çmimin "MOROSO", Itali. Ai ka qenë drejtor artistik i bienales së artistëve të rinj nga Europa dhe Mesdheu, "Mediterranea 18", që u zhvillua për herë të parë në vitin 2017 në qytetet e Tiranës dhe Durrësit. Është bashkëthemelues i Platformës së Artit Bashkëkohor Harabel në Tiranë. Veprat e tij janë paraqitur në: GAMeC, muze i artit modern dhe bashkëkohor, Bergamo (2019);

Passerelle, Centre d'art contemporain, Brest (2018); Mostyn Gallery, Uells, Britani e Madhe (2017); MuCEM, Marsejë (2016); Academie de France à Roma (2016); Centre Pompidou, Paris (2016); IV Bienal del Fin del Mundo, Kili (2015); GAM, muze i artit modern dhe bashkëkohor, Torino (2013); White House Biennial, Athinë (2013); KCCO, Klaipeida, Lituani (2013); ZKM,

Karlsruhe (2012); MUSAC, Castilla León, Spanjë (2012); Bienalja e Pragës 5, Pragë (2011); Tron-gate 103, Glasgou (2011); Galeria Kombëtare e Kosovës, Prishtinë (2010); Museo d'Arte Contemporanea Villa Croce, Genova (2009); Galeria Kombëtare e Tiranës (2008).

Driant Zeneli, kuruar nga Alicia Knock. Si i shtyjme kufijtë tanë fizikë dhe mendorë pa u bërë superheronj? A mund të bashkëtojnë e

mundura/realja dhe imagjinaria? Në thelb të hulumtimit të Dritant Zenelit qëndron ripërkufizimi i dështimit, utopisë dhe ëndrrës. Nëpërmjet rrëfimit filmik dhe performancës, Dritant Zeneli sfidon

përpjekjen ngulmuese të njerëzve ndaj kufijve të tyre, duke nxjerrë në dritë përgjigjet e mundshme të brishtësisë së qenieve njerëzore dhe planetit Tokë. Ai sfidon marrëdhënien fizike dhe metafizike midis njeriut dhe hapësirës, materies dhe ëndrrës, gravi-

Arion Hysenbegas. Instalacioni zhvillohet nga një film me dy kanale, ngjarjet e të cilit zhvillohen

dustrial të errët dhe dramatik në një hapësirë shumëvlerëshe për kolaps dhe fluturim. Nëpërmjet







# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 654

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 30 Mars 2019

**KA SHOQËRI PAS NDARJES? STINE SQARON RAPORTIN ME ROZEN**

## SAIMIR TAHIRI

**EKSKLUZIVE**



**BASHKËSHORTJA E ISH-MINISTRIT PRET DJALIN E DYTË**



**EKSKLUZIVE**

## "RALLY I PRINCESHAVE"



**KUSH JANË VIP-AT QË MARRIN PJESE NË GARË**

## RIKE ROÇI

**EKSKLUZIVE**



**REAGON PAS FOTOS SË POSTUAR NË 'INSTAGRAM'**

# EINXHEL SHKIRA

## S'KA KOHË PËR LIDHJE? JA SAKRIFICAT PËR KARRIERËN



# S'ka kohë për lidhje? Einxhel Shkira tregon sakrificat për hir të karrierës




**T**ë kesh sukses ditët e sotme kërkohen sakrificat dhe këtë ka bërë edhe moderatorja e njohur Einxhel Shkira. E ftuar në emisionin "Tag", Einxhel foli për eksperiencën e saj si moderatore e programit "E diell". Për të s'është aspak e lehtë pasi i është dashur të heqë dorë nga shumë gjëra, si pijet alkoolike apo daljet në darkë. "Maksimumi i argëtimit tim tani është divani, televizori nderur, 1 milion ushqime tek tavolina ngjitur me divanin", tregon moderatorja. Por, gjithashtu, ajo duket se ka hequr dorë edhe nga lidhjet, pasi nuk ka më kohë. "Kam lënë edhe gjëra të tjera, gjëra që fillojnë me 'S' që kur ka filluar 'E diell'. Nuk kam pasur realisht nerva dhe kohë fare për t'u marr me asnjë njeri. E vetmja gjë që dua pas punë është të kthehem në shtëpi, të rri vetëm dhe të fle", tregon ajo. Por një gjë është e sigurtë, eksperiencia e nisur është një plus në karrierën e saj dhe duket se do ia vlejë sakrificat e ndërmarrë.



## 'Ndihesha keq mendërisht', këngëtarja shqiptare rrëfen periudhën e vështirë që ka kaluar

**N**uk janë të paktë personazhet e njohur të ekranit, të cilët kalojnë vështirësi si të gjithë njerëzit e tjerë. Edhe këngëtarja e njohur Flaka Krelani paska kaluar një periudhë të vështirë në jetën e saj. Fundi i 2018-ës dhe fillimi i 2019-ës nuk kanë qenë shumë pozitiv për të, por ajo ka gjetur motivimin dhe ka një mesazh për të gjithë ata që po kalojnë të njëjtën gjë si ajo. "Fundit i

vitit 2018 dhe fillimi i vitit 2019-ës ka qenë i vështirë për mua fizikisht dhe mendërisht. Arsyeja që po shprehem kaq shumë, është sepse secili prej nesh ka vështirësi, të cilat janë normale, zhgënjimet, gjithashtu, janë normale, si mungesa e motivimit, nuk është fundi i botës apo gjëra të tjera që na bëjnë të ndihemi keq. Do të doja të gjitha të ishin si ilaçe që të mund t'i konsumoja çdo ditë, sepse



më ndihmojnë të arrij gjithçka që dua në jetë. Ajo që jemi, është ajo për të cilën jemi të gatshëm të luftojmë. Kthejeni veten në prioritet dhe mos e ktheni "problem" në problem, sepse ai nuk ekziston. Shëndeti është

të e vetmja gjë e rëndësishme në jetë", -ka shkruar këngëtarja. Një mesazh vërtet i ndjerë i këngëtares. Duket se ka kaluar vërtet një periudhë të vështirë në jetën e saj që fatmirësisht e ka lënë pas.





Pamela Aliaj

**A**rdhja në jetë e një fëmije është lajmi më i bukur dhe më i veçantë për një familje. Shumë nga personazhet e njohur mundohen që jetën e tyre private ta mbajnë të fshehtë dhe sidomos larg vëmendjes së mediave. Por së fundmi kemi zbuluar një 'të fshehtë' shumë të bukur. Burime për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" na kanë thënë se bashkëshortja e ish-ministrit të brendshëm, Saimir Tahiri, është shtatzënë dhe në javët e fundit të saj. Familja Tahiri së shpejti do të rritet me djalin e dytë që do të sjellë në jetë Fatlinda Berisha. Edhe pse janë munduar ta mbajnë të fshehtë për një kohë të gjatë dhe bashkëshortja e ish-ministrit nuk ka dalë shpesh në fokusin e kamerave, ky lajm i bukur s'kishte se si të shpëtonte për mediat. Nëna e një djaloshi të quajtur Drin, tashmë në javët e fundit të shtatzënisë, do të sjellë në jetë vogëlushin e dytë në familjen Tahiri. E ku ka lajm më të bukur se ky? Urojmë që të vijë sa më mirë dhe të ketë jetën e gjatë, dhe sigurisht të shohim ç'emër shqiptar do t'i vendosi mami Fatlinda dhe babi Saimiri vogëlushit.



Së shpejti do të bëhen 4, gruaja e ish-ministrit sjell sërish gëzim në familje

# Bashkëshortja e ish-ministrit Saimir Tahiri është shtatzënë



*Në javët e fundit të shtatzënisë, Fatlinda Berisha pret djalin e dytë*



**EKSKLUZIVE**





## I bashkohet politikës, këngëtarja e njohur pjesë e partisë kosovare

**P**rej pak javësh, Eliza Hoxha, këngëtarja e njohur nga Kosova është përfolur për një mundësi angazhimi në radhët e politikës, por deri sot gjithçka kishte mbetur në kuadrin e thashethemeve. Ajo i mohoi fjalët dy javë më parë duke u shprehur se, nëse do e marrë këtë vendim do e bëjë vetë publik. Siç duket sot është finalizuar gjithçka. Ka qenë kryetari i PDK-së (Partisë Demokratike të Kosovës) ai që ka bërë me dije lajmin krahas një fotoje me këngëtarën. "Mirë se erdhe në PDK, Eliza. Profesionalizimi dhe dashuria jote për Prishtinën janë vlerë e madhe në Dekadën e Re, ndërsa PDK mbetet hapësira më e mirë për secilin që ka vizion, plan dhe dëshirë për ta ndryshuar vendin. Me ty dhe të tjerët, Dega e PDK-së në Prishtinë i jep kryeqytetit atë që po i mungon prej kohësh: vullnetin për t'ia zgjidhur problemet", - shkruan Kadri Veseli krahas postimit. Ky do të jetë një hap tjetër në karrierën e Elizës, e cila më herët ka qenë pjesë e festivaleve më të rëndësishme shqiptare dhe ka qenë moderatore dhe autore e një programi televiziv dedikuar arkitekturës.

## Rikthehet Rita Ora, viziton Kosovën në prill për një kauzë të veçantë

**S**ë fundmi këngëtarja e mirënjohur Rita Ora ka lançuar bashkëpunimin me markën e çantave Escada, e cila do dhurojë për çdo shitje të çantave të dizenuara nga këngëtarja, 15 euro në ndihmë të fondacionit "Women for Women International". Ky fondacion ndihmon femrat që kanë arritur t'ia dalin mbanë luftës dhe dhuron ndihma që të marrin veten. Gjatë intervistës për promovimin e kësaj nisme të re dhe lançimit në treg, Rita ka rrëfyer se lufta lidhet ngushtë me origjinën e saj, duke marrë parasysh luftën që është zhvilluar në Kosovë. Më tej ajo njoftoi se do vijë në vendlindje për disa punë bamirësie gjatë prillit. Kujtojmë se Rita ka marrë titullin 'Ambasadore Nderi' nga ish-Presidentja Atifete Jahjaga dhe ka të drejta të plota për përfaqësimin e Kosovës në evente të tilla. Një kauzë për t'u duartrokatur dhe marrë shembull!



## Ka shoqëri pas ndarjes? Stine sqaron raportin me Rozën

**E**dhe pse kanë shumë vite që i kanë dhënë fund lidhjes së tyre Roza Lati dhe Stine komentohen shumë shpesh në mediat rozë. Siç dihet, disa muaj më parë Stine u nda nga partnerja e tij me të cilën ka dhe një vajzë dhe vetëm pak ditë më parë ai u filmua pranë ish të dashurës, Roza Latit. Ishte vetë Roza ajo që publikoi një video ku shihej duke u argëtuar në një lokal nate së bashku me këngëtarin e njohur. Mirëpo, Stine ka dhënë së fundmi një intervistë për një media rozë ku ka sqaruar një herë e mirë marrëdhënien e tij me Rozën. Teksa është pyetur nga gazetarja se, nëse po ndodh sërish diçka mes tyre, Stine ka thënë: "Portalet atë punë kanë dhe mirë bëjnë se nga njëra shërbejnë dhe si mbështetje. Midis meje dhe Rozës nuk do ketë kurrë asgjë më tepër sesa një miqësi të mirë dhe të pastër. A besoj unë në të tilla miqësi? Në fakt, dikur nuk besoja në gjëra të tilla, ama është fakt që ne ruajmë një miqësi korrekte pa tundime dhe pa hipokrizi që nga edicioni i fundit i "Dance with me" që ishim pjesëmarrës".



## Ndjek trendin e kohës, Kiara Tito ndryshon totalisht look

**D**uket se këtë sezon të shumta janë vajzat e njohura të ekranit që po guxojnë me 'look-un' e tyre, më së shumti me modelet e flokëve. Kohët e fundit kemi parë shumë të famshme shqiptare, që i kanë prerë flokët shkurt dhe duket se kjo po përhapet me shpejtësi si një lloj tendence. Këtij grupi i është bashkuar së fundmi edhe moderatorja Kiara Tito. Nëpërmjet 'Instagram-it' ajo ka treguar se ka prerë flokët, por nuk ka qenë ende gati për këtë ndryshim. Kiara i ka prerë flokët në modelin 'bob' dhe që nga fillimet e saj në ekran kjo është hera e parë që e shohim me këtë lloj stili. Kiara Tito ka guxuar shpeshherë me pamjen e saj dhe gjithmonë është dukur shumë bukur, prandaj me siguri dhe këtë herë do ketë goditur në shenjë. Të shohim kush e ka radhën tani për të prerë flokët.





Pamela Aliaj

Nga Klea Huta tek Anila Basha, pjesëmarrëse figurat e njohura të medias

# Starton "Rally i Princeshave", kush janë ftuarit VIP

*Me një itinerar Tiranë-Korçë-Tiranë 300 km, kushtet dhe adrenalina e garës së sotme*

**D**ita e sotme, 30 mars, do të rikthejë në Shqipëri "Rally of Princess", apo "Rally-n e Princeshës", një garë që dalëngadalë po kthehet në traditë çdo vit. Organizatorët e "Rally Albania" kanë përgatitur gjithçka, ndërkohë që kjo garë është konceptuar në formën e një parade femrash në timonin e makinave. Në vitet e fundit, ajo ka dhuruar momente emocionuese, edhe pse qëllimi i vërtetë nuk është garimi, por krijimi i një tradite femrash në garat e automobilizmit. Femrat pjesëmarrëse në këtë garë duhet të zotërojnë një patentë të rregullt dhe një makinë, ndërsa thuhet se në garë marrin pjesë 50 makina me 100 femra, 2 në secilën makinë (kopilote). Për "Gazeta Shqiptare" organizatorët kanë treguar që gara të jetë e hapur për çdo femër që ka dëshirë të marrë pjesë. Edhe këtë herë, organizatorja kryesore e garës është Julinda Dhame, e përhershme në evente të kësaj natyre dhe njëkohësisht, një nga krijueset e garës "Rally Albania". "Rally i Princeshës" është një garë e krijuar në vitin 1929 në Francë, me "Paris Saint Raphael Ladies Rally" dhe që atëherë është zhvilluar pothuajse çdo vit. Tashmë ajo ka krijuar traditë në shumë vende të botës, ndërkohë që në Shqipëri zhvillohet për herë të tretë. Sipas organizatorëve, ajo do të jetë në një format më të plotë dhe është e krijuar posaçërisht për shijet e femrave. Kjo garë është e tipit "regularity" dhe nuk bazohet në shpejtësi të kohës, por në arritjen sa më afër të një kohë të përcaktuar më parë, që quhet "Target Time". Në të do të marrin pjesë vajza të njohura në fusha të ndryshme të jetës, nga media, juriste, ekonomiste, sipërmarrëse private etj. Kjo nuk është garë shpejtësie, por rregullash, të qëndrosh më pranë shpejtësisë së lejuar. Do të pranohen të marrin pjesë 50 ekipe, që përbëhen nga dy femra në çdo makinë. Ndërkaq, në eventin e hapjes morën pjesë shumë figura të njohura të medias si Klea Huta me motrën, Ledia, bashkëshortja e ish-futbollistit Redi Jupi, Vivian; bashkëshortja e Ar-



**EKSKLUZIVE**



**PRINCESS RALLY-2019 PROGRAMI**

**E premte, 29 mars 2019**  
Kalaja e Familjes Toptani, bar "N'Çarshi"  
Ora 18:00 deri 20:00  
Producat e pagës dhe pajisja e garës me materialet e garës.  
Ora 20:00 - Briefing për detajet e garës.

**E shtunë, 30 mars 2019**  
Sheshi Skënderbeu/Janina Murot Hotek Kombit dhe Hotel Tessa  
Ora 10:00 - Start Etapa I (nisa individuale e makinave sipas rregullës së regjistrimit)  
Ora 14:00 - Pit Stop për kafë në fshatin Lin, në Pogradec.  
Ora 15:00 - Vazhdimi i garës në drejtim të Korçës.  
Me mbetjet e Korçës, do të bëhet shprehja në Hotel Bravo dhe Hotel Vizion të cilat gëzojnë shantë afër Pazarit të Korçës. Përkrahje të sigurt për hotelin nga organizatorët.  
Ora 20:00 - Darka në "Le Petit Paris", me muzikë live Korçare.

**E diel, 31 mars 2019**  
Ora 11:00 - Starti Etapa II, nisa individuale e makinave sipas rregullës së regjistrimit.  
Ora 14:00 - Pit Stop për kafë pranë liqenit të Gramshit  
Ora 20:00  
Ceremonia e ndarjes së çmimit të Kalajës e Familjes Toptani, bar "N'Çarshi"







Pamela Aliaj

**B**ukuroshja e njohur si ish-banorja e 'Big Brother 2', Rike Roçi shpesh është në qendër të vëmendjes së fansave dhe mediave rozë. Së fundmi ka bërë një bashkëbisedim me ndjekësit e saj të shumtë në "Instagram". Fansat kanë qenë kuriozë të dinë se sa ka zgjatur lidhja e saj me reperin e njohur, Noizy. Dyshimet se dyshja janë në një lidhje, erdhën pas komenteve pikante që shkëmbejnë dhe fotot ku



**Bukuroshja e 'Big Brother' shfaq të rejtat lidhur me modelingun**

# POSTOI TË DASHURIN?

## Rike Roçi reagon pas fotos së publikuar në 'Instagram'

*Menduan se ishte i dashuri i ish-banores, si qëndron e vërteta*

kishin pozuar bashkë. Por një gjë të tillë ata e kanë mohuar. Vetë Rikja tregoi se nuk ka asgjë tjetër përpos shoqërisë me reperin: "Ehaa kam thënë disa herë që kurrë s'kemi qenë të lidhur, u bë vite me këtë histori, boll. Vetëm shoqëri". Me këtë përgjigje që



dha, Rikja zbuloi se ishte lodhur me këtë thashetheme e se tani kërkon që të mos flitet më për të. Së fundi, ajo ka bërë një tjetër postim ku publikon foton e një mashkulli. "Eh po, kam rënë në dashuri", shkruan ajo në foton ku shfaqet presidenti i lëvizjes "5 Stelle" në Itali, Luigi di Maio. Mjaftoi kaq që të kishte reagime nëpër mediat rozë dhe ish-banorja ta hiqte foton nga 'Instastroy' i saj. E pyetur lidhur me këtë gjë, Rike ka thënë për "Gazeta Shqiptare" se ishte vetëm një shaka dhe asgjë më shumë. Ndërkaq nga ana tjetër në 'Instagramin' e saj shohim shpesh postime të ku ish-banorja është duke u përgatitur për një projekt modelingu. Gjithashtu, kujtojmë se bukuroshja nga Durresi ka nisur provat për të qenë pjesë e Kinematografisë në Itali. Shumë të reja interesante pret të sjellë Rikja dhe ky është vetëm fillimi!





## Sa shumë kanë ndryshuar! Shihni sa janë rritur fëmijët e Altin Bashës

Ai është një nga personazhet, i cili si regjisor i shumë show-ve, preferon që jetën private ta mbajë larg 'prozhektorëve'. Daljet publike dhe intervistat nëpër media të ndryshme për Altinin dhe bashkëshorten Ilirjana janë të rralla. Megjithatë çifti i njohur, si rrallë janë shfaqur publikisht së bashku me dy fëmijët më të rritur në premierën e filmit "2 gisht mjalte". Engjëllushja dhe Erblini, ndonëse kanë prindër të famshëm, nuk janë të njohur për mediat dhe dalja e tyre tregoi sa shumë kishin ndryshuar. Çifti ka dhe një djalë të vogël të quajtur Rron që me siguri do ta shohim në eventin e radhës kur të jetë mjaftueshëm i rritur për të dalë me familjen zyrtarisht për median.

## Me prind të famshëm! Ja ç'punë bën babai i Capital T në Kosovë

Capital T është një ndër reperët dhe këngëtarët më të pëlqyer nga të rinjtë e jo vetëm. Por për sa i përket familjes së tij, shumë pak ose aspak dimë. Ndërkaq së fundmi u zbulua se Capital T qenka djali i një personazi të njohur në Kosovë. Këngëtari, emri i vërtetë i të cilit është Trim Ademi, ndonëse është munduar ta mbajë larg vëmendjes së publikut familjen e tij është mësuar se është i biri i Agim Ademit, kreu të Federatës së Futbollit në Kosovë. Agim Ademi qëndron në krye të institucionit më të rëndësishëm futbollistik në Kosovë pas ndarjes nga jeta të ish-drejtuesit të njohur Fadil Vokrri.



## Skenat e sikletshme me Elvanën, Ermali tregon si ishte të puthje këngëtarën

Si është të puthesh me atë që e konsideron vëlla? Është pak e sikletshme apo jo? Epo kjo gjë i ka ndodhur Ermalit dhe Elvanës në filmin "2 gisht mjalte" një komedi që po shfaqet në kinematë shqiptare prej 28 marsit. I ftuar dje tek "Rudina", Ermali ka rrëfyer se kjo skenë në film ka qenë shumë e sikletshme, sepse Elvanën e konsideron si motër. Ai është shprehur se me Elvanën ka qenë ndryshe, sepse edhe më parë ai është puthur me Enxhi Cukun në filmin "Femrat", por Elvana është pjesë e familjes. "Të puthësh Elvanën është njësoj si të puthësh njerëzit e shtëpisë", është shprehur Ermali. Nga ana tjetër Elvana në pre-premierën e filmit u shpreh për puthjen me Ermalin: "Si nuk më hëngri mortja që e putha unë këtë". Siklet i madh.



## Këngëtari i rikthehet muzikës, ja me kë do të jetë bashkëpunimi i radhës

Pas daljes së albumit "Fortuna", reagimi i artdashësve ishte shumë i madhe dhe padyshim ky ishte një nga albumet e vjera për muzikën shqiptare. Tekstet e Aida Barakut dhe muzika e Armend Rexhepagiqit, e rikthyen sërish këngëtarën Tuna fuqishëm në treg. Edhe kënga e Elvana Gjatës "Tavolina e mërzisë" është një tjetër sukses i dyshes së artistëve. Mirëpo, Armend Rexhepagiqi mesa duket ka vendosur t'i rikthehet muzikës sërish pasi këngëtari i njohur Mentor Haziri, ka lajmëruar përmes një postimi në Instagram se së shpejti do të vijë një bashkëpunim mes tyre. Edhe Mentori është një zë i veçantë i muzikës shqiptare dhe me siguri do të jetë një hit edhe kënga e tyre.

Opinion i Ditës

# Asgjë e re nga fronti i protestave

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

Të arrish të konsiderosh çast të rëndësishëm një detaj të tillë do të thotë se zjarrmia e protestës opozitare ka filluar të bjerë. Akuzat-kuaj për qeverinë e krim-it, drogës dhe vjedhjes, ashtu të përsëritura protestë pas proteste dhe pa forcën e rrisë, ngjanin si të lodhura në gojën e folësve dje. Njëllorji si dy gishtat e ngritur lart. Për të mos folur për efektin mbi dëgjuesit. Rruga e gjatë e protestave të përjavshme qytetare përpara Kuvendit është një sport i vështirë. Kërkon shumë parapërgatitje. Për të bindur jo vetëm militantët që ke me vete në marshim, të ndihmuar nga bori tifozash (ata praktikisht shërbejnë si figurantë të spektaklit-protestë), por ata qindra e mijëra qytetarë që të ndjekin përmes kamerave televizive. Argumentet e paprovuara kurrë të përfshirjes në tregtinë e drogës dhe në aktivitetet kriminale, apo të blerjes masive të votave në zgjedhje nga kjo qeveri e sotme, tani kërkojnë mbështetje serioze për betejën e gjatë. Opozita jashtë parlamentit duhet të zgjedhë kauzën ekonomike si motor shtesë. Aty ku u dhemb vërtet njerëzve. Tek mungesa e perspektivës, e shpresës për të ndërtuar një jetë dinjitoze në vendin tënd. Tek mungesa e mbështetjes së qenësishme shtetërore të prodhuesve shqiptarë, atyre që sjellin vlerën e shtuar në ekonominë tonë. Tek humbëtitira e shpresës për hapjen e mijëra vendeve të reja të punës. Tek mungesa e shanseve për të depërtuar në treg ose për të marrë oferta dhe para shtetërore për mallin që prodhon apo shërbimin që kryen, për shkak se pothuajse të gjithë tenderët qeveritarë janë të trukuar dhe fituesi i paracaktuar. Asnjëherë



në këto gjashtë vjet opozita nuk i ka marrë seriozisht këto mungesa, këto shkelje të mëdha të një boshti politike zhvillimi ekonomik për vendin. Është mjaftuar me disa hartime-denoncime në konferenca shtypi, ku thjesht ka prodhuar me qindra

insinuata e sulme për paudhësi hipotetike, se sa fakte kokëforta. Asnjëherë gjetjet e mirëargumentuara të Kontrollit të Lartë të Shtetit në shumicën e mbi 150 kontrolleve që ai kryen çdo vit nuk i ka bërë kuaj betejë të vepërimit të saj për të goditur pa-

përgjegjshmërinë ekstreme në qeverisjen e parave të shqiptarëve. Kur normalisht në çdo vend të botës opozita këtë bën. Tek ne opozita jonë as edhe merr mundimin t'i lexojë raportet e kontrolleve të institucionit të kontrollit shtetëror më të lartë

të vendit. Madje disa shifrave përmbledhëse të këtyre raporteve përfaqësues të opozitës ka patur raste që edhe u janë referuar gabim. Ose nga moskuptimi, ose nga mosleximi i plotë. Në këtë mënyrë nuk mund të ngjallësh shpresë ose, akoma dhe më tepër besim, në sytë e qytetarëve. Janë të rrallë ata që ende shpresojnë se mund të ndryshojë diçka në qeverisje nga protestat e përjavshme të opozitës sonë. Shumica e qytetarëve të Tiranës tanimë kanë nisur ta shikojnë me tepër si një bezdi të rëndimit të trafikut. Ky është problemi më madhor dhe sfida më e fortë e opozitës sot. Që me protestat-marshime nuk po arrin të ngjallë frymë opozitare. Prandaj dhe (nëse nuk e ka të programuar vetë këtë rënie graduale të stinës së protestave deri në greminën e rutinës), opozita në rrugë duhet të ndryshojë marsh. Të mbështetet më shumë në fjalime me megafon, në akuzat dhe kërkesat me natyrë ekonomike. Kjo mund të rrezikojë deri diku të prishë imazhin e një opozite gati-gati revolucionare mburojë e mosprekjes së drejtuesve të vet, por ama i bën argumentet e saj më pranë halleve të përditshme të njerëzve. E kthen opozitën në rrugë nga një trupë të përbehtuar për ruajtjen e një grali të shenjtë që nuk kuptohet mirë se çfarë është, në një zëdhënës të rreziqeve të hendeqeve të mëdha ekonomike që kemi. Pasiguritë dhe problemet ekonomike kanë rrezuar nëntë nga dhjetë qeveri në 78 të tilla që janë ndërruar me rotacion partish politike në 32 vende të Evropës këto 10 vitet e fundit (statistikë e Institutit Evropian për Zhvillim Ekonomik me qendër në Vjenë). Nuk ka pse vendi ynë të bëjë përjashtim. Problemet e sotme ekonomike të shqiptarëve janë temat më të rëndësishme dhe më me vlerë të shoqërisë sonë. Opozita në rrugë duhet t'i përfaqëtojë dhe mishërojë ato fort, nëse do karburant për marshimet e saj të ardhshme. Ndryshe nuk do të kemi asgjë të re nga fronti i protestave.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ





Opinioni *i* Ditës

# Shqipëria, Samiti i Poznanit dhe qesja e BE-së?!

Nga Ben Andoni

(vijon nga faqja 1)

Takimi i radhës në Poznan është i gjashtë që vjen pas mbajtjes në disa qytete të vendeve kryesore të BE-së, ku delegacionet e larta ballkanike do të paraqesin ecuritë e Procesit në vendet respektive. Për fat të keq, fryma pozitive që u ngrit në takimin e parë në Berlin dhe përfshirjen e fortë të Gjermanisë në procesin e iniciuar nuk është se i është përgjigjur si duhet entuziazmi dhe reagimit të vendeve pjesëmarrëse dhe bashkëpunimit të tyre në praktikë.

Gjashtë vende anëtare të BE-së: Austria, Kroacia, Franca, Gjermania, Italia e Sllovenia janë anëtarë të përhershme të Procesit të Berlinit, kurse Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi e Serbia po mundohen ta mbajnë gjallë Procesin e zbehur disi tashmë.

Kjo mund të kuptohet në një areal më të gjerë të situatave, ku pas krizës ekonomike dhe financiare globale të 2008-ës, krizat më të vogla prekën fusha të ndryshme në Spanjë, Portugal, Qipro, Irlandë, në Itali e sidomos në Greqinë fqinje. Sikur të mos mjaftonin këto, Evropa u përball me erën e luftës, që solli agresioni rus në Ukrainë dhe dyndja e pamatë e emigrantëve prej disa drejtimeve. Kur erdhi koha e Brexit-it, pak muaj më parë, Evropa dukej gati e dorëzuar para frymës Euroskeptike që pushtoi të gjithë BE-në, bashkë me urrejtjen e ekstremeve të majta dhe të djathta dhe sidomos mosbesimit qytetar, që kulmoi me protestat të ashpra ngado.

Në rajonin tonë, vendet anëtare të procesit të Berlinit duket se kanë bërë hapa pas në marrëdhënien e tyre. Nga ana tjetër, sot, opozitat në Malin e Zi, Shqipëri dhe Serbi po ushtrojnë protesta të përvajshme dhe të unifikuara me gjendje që tregojnë se ka vija demarkacioni shumë të mëdha të mendimit opozitar me pushtetin. Kurse përjashtimi i Ballkanit Perëndimor nga Samiti i Sibutit në Rumani, që mbahet në majin e këtij viti, tregon se Evropa punon me dy regjistra, ndaj edhe zhgënjimi i vendeve tona është bërë gjithnjë e më i mprehtë dhe më i hapur.

Në takimin e Poznanit, njërit prej qyteteve më të mëdhenj të Polonisë, e theksojmë këtë fakt (shkallëzimi i peshës së simbolikës së qyteteve i përgjigjet disi dhe gjendjes së Ballkanit Perëndimor), duket se peshën më të madhe do i delegojë për temat që lidhen me shoqëritë civile, rininë për të kulmuar pastaj me biznesin dhe problemet politike, ku ministrat dhe kryeministrat respektivë të Ballkanit Perëndimor do të shtrojnë të gjithë problematikën e tyre.

Samiti i Poznanit ka të ngjarë të vuajë apo të korrë sukses falë rezultatit që do të sjellin zgjedhjet në



Parlamentin Evropian (askush deri më sot nuk është i zoti të nxjerrë një rezultat paraprak të strukturës së saj përbërëse), ashtu si sot që po shkruajmë nuk parashikohet dot nëse Brukseli do të hapë apo jo negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, apo do të liberalizohen vizat me Kosovën apo jo! Ndonëse Samiti u themelua me shumë gazim si një iniciativë ndërqeveritare për të nxitur integrim më të madh praktik midis vendeve tona të rajonit, ajo tashmë është stopuar jo pak për shkak të shumë mosmarrëveshjeve (Kosovë-Serbi është më e madhja syresh), por edhe pamundësisë së administratave për të përgatitur projekte dhe për t'u përgjigjur frymës.

Samiti i Poznanit, paqka frymës optimiste që po mundohet të ngjallë vetë Polonia, e cila po e mban mbi shpatulla këtë iniciativë, nuk është se i përgjigjet realitetit. Jo vetëm Bashkimi Evropian, por edhe vendet kryesore që i përgjigjen kësaj iniciative kanë shumë paqartësi. E para nga fryma populiste, e cila po ngrëthen Europën (vendet e Procesit), por edhe nga gjendja demokratike e disa prej vendeve ballkanike që janë pjesë e këtij procesi. Dhe, nuk mbaron këtu. Qysh prej Berlinit, fanfarat e arritjeve dëgjohej gjith-

një e më pak, sepse nga samiti në samit zëri evropian është sfumuar jashtëzakonisht. Brexit dhe Ukraina e kanë ulur vëmendjen, që në rastin e samitit të Polonisë lidhet me arritjet dhe premtimet e samiteve të shkuara.

Në kohët e para të ekzistencës së procesit, Bashkimi Evropian ishte disi i qlluar dhe me pritëri krejt të tjera, që ekuilibronte disi edhe shkimet e ekudërta midis disa shteteve anëtare sa i përket politikës së zgjerimit. Asokohe Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ai i Serbisë Aleksandër Vuçiq u treguan dhe u përshfaqën si promotorë të zhvillimit dhe falë një momenti të mirë mes tyre kjo u përcoll dhe tek liderët e tjerë të rajonit. Filluan të materializohen fusha të interesave të përbashkëta, që kulmuar me iniciativën rinore: krijimi i RYCO (Regional Youth Cooperation Office), miratimi i një liste të projekteve investuese në transport dhe energji etj. Më tej akoma, lidhur me plotësimin e angazhimeve Shqipëria dhe Mali i Zi patën përafërim 100% me kërkesat evropiane, Maqedonia Veriore me 85.19%, pastaj Bosnja dhe Hercegovina me 66.67% dhe së fundmi ishte Serbia, që për shkak të aspektit politik u përshat me vetëm 51.85% të kërkesave të Brukselit.

Në terma më konkretë, sa i për-

ket bashkëpunimit ekonomik, Procesit të Berlinit e ka lehtësuar disi punën e Komisionit të BE-së në mënyrë që të ofrojë asistencë dhe mbështetje të shtuar për vendet e rajonit. Për fat, Shqipëria përfitoi në Samitin e Parisit, projektin për rehabilitimin e hekurudhës Tiranë-Durrës dhe ndërtimin e hekurudhës Tiranë-Rinas. Shqipëria përveç këtij projekti ka fituar edhe atë të interkonjeksionit elektrik me Maqedoninë e Veriut, projekte që gjithsesi nuk e kanë dhënë impaktin e tyre, pasi ende nuk kanë nisur.

A ka shumë Shqipëria për të treguar në Poloni? Në rast të një lajmi negativ, sa i përket procesit evropian, do të jetë një pjesëmarrje sa për të respektuar procesin dhe dhënie llogari për projektet; kurse sa i përket Polonisë, Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor mund të marrin asistencën e saj kryesisht dhe pastaj të vendeve të Vishegradit për mënyrën sesi ato kanë zgjidhur pajtimin, por edhe mund të mësojnë nga burokracitë demokratike të këtyre vendeve që kanë arritur të përshatën mrekullisht dhe në kohë rekord me Brukselin duke i përballur realitetet e problemeve të vendeve të tyre. Atë, që vendet tona e presin vetëm nga hapa e qesës gjithnjë e më të vogël të BE-së. (Gazeta Shqiptare)

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të kujtojnë një këshillë të dhënë nga dikush jo shumë së buxheti juaj, pasi do të luteni në vëshitësi. Rekomandohet që në mbërmeja të mos mendoni rreth problemeve, por të jeni pjesë e një eventi plot gjallëri.

### DEMI

Demët duhet të mbajnë nën kontroll financat. Përpquni të mos shpenzoni më shumë se buxheti juaj, pasi do të luteni në vëshitësi. Rekomandohet që në mbërmeja të mos mendoni rreth problemeve, por të jeni pjesë e një eventi plot gjallëri.

### BINJAKET

Binjakët do të mendojnë pozitivisht gjatë kësaj dite. Ka mundësi të zhvillojnë një takim romantik mjaft interesant. Ata që janë në kërkim të dashurisë nuk duhet të refuzojnë ftesat nëpër evente argëtuese.

### GAFORJA

Gaforret mund të acarojnë një prej miqve ose të afërmeve. Ekziston mundësia që të jeni dëshmitarë i një konflikti dhe do të dëshironi të largoheni sa më shpejt të jetë e mundur. Do të përjetoni momente të paharshme gjatë një takimi romantik që kishit kohë që e prisnit.

### LUANI

Luanët rekomandohen që të monitorojnë me kujdes dietën ushqimore. Ekziston rreziku që t'u shkaktohen probleme pikërisht për regjimin e varfër ushqimor. Pjesa tjetër e kësaj të shtunë do t'u sjellë kënaqësi dhe do të gjeni mundësi të relaksoheni.

### VIRGJERESHA

Mund të dilni nga rutina e kësaj dite vetëm me anë të kreativitetit dhe eksperimenteve të reja. Ata që kanë bërë plan prej kohësh të bëjnë riparime në shtëpi është dita e duhur për t'u nisur ato. E shtuna nuk është e përshatshme për reforma në marrëdhënien tuaj të dashurisë.

### PESHORJA

Disa Peshore nuk do të jenë të kënaqura nga vetja. Ekziston rreziku të mos impresiononi disa persona prej të cilëve varen disa çështje të rëndësishme. Gjithashtu, mund të përballeni me probleme financiare. Opsioni më i mirë është të kurseni sa më shpejt të jetë e mundur.

### AKREPI

Nuk është dita e duhur për të eksperimentuar me stilin e të veshurit. Do të ishitë e udhëtë të përshihen në gjëra më të rëndësishme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën tuaj. Një ndër prioritetet sot mund të jenë edhe punët e shtëpisë.

### SHIGJETARI

Ka gjasa të përshihen në disa incidente qesharake. Gjatë kësaj të shtunë do të qeshin shumë duke bërë të kaloni një ditë të paharshme. Në mbërmeja, do të ishte mirë të mbanit premtimet dhe të dilnit me mikun tuaj të ngushtë ose me një afërimin tuaj.

### BRICJAPI

Bricjapët do ta zgjerojnë rrethin e kontakteve. Ka gjasa të bëni miq të rinj dhe të fuqishëm. Do të lini një përshytyje mjaft të mirë me humorin që ju karakterizon. Është ditë e përshatshme për të nisur një romancë të re.

### UJORI

Ujorët do të inkurajohen nga vizita e dikujt. Mësoni t'i besoni intujtë tuaj, pasi punët do t'u shkojnë më mirë se e kishit menduar. Megjithatë, nuk përshatohet mundësia për irritime gjatë kësaj dite.

### PESHQIT

E shtuna do të përbëhet nga momente të këndshme. Propabilitet për takime dhe udhëtime të shkurtra është i lartë. Disa mund të rinisin një lidhje romantike të lënë përgjysmë. Sa i përket çifteve të martuar, mund të merrni një çuratë nga partneri/partnerja juaj.

**PRESIDENTI I KUKËSIT**

**Gjici: Cuculi gaboi, Partizani i ka qejf penalltitë**

Presidenti i Kukësit, Safet Gjici, u shpreh shumë i zhgënjyer pas barazimit ndaj Partizanit, ku e vuri theksin te gabimi i rëndë i Cuculit që shkaktoi penalltinë, por nuk la pa thumbuar as ekipin kundërshtar, duke u shprehur se i ka qejf penalltitë. "Natyrshisht që të zhgënjyer pas barazimit, e kishim lojën në dorë, por



ishte gabim i rëndë i Cuculit. Nuk e di tamam a ishte apo jo penalti, por ju e dini që Partizani i ka qejf penalltitë. Titulli një ëndërr? Matematika na e lejon, kemi ende shumë pikë në lojë. Ëndërr nuk ka", - u shpreh presidenti Gjici pas ndeshjes.

**PRESIDENTI I PARTIZANIT**

**Demi: Meritonim fitoren, shpresoj t'i kemi mirë gjunjët**

Presidenti i Partizanit, Gazmend Demi, foli pas barazimit të ekipit të tij ndaj Kukësit, ku u shpreh se në fakt ekipi i tij e meritonte fitoren, ndërsa tregoi se e mbajnë gjunjët, ndërsa ka ironizuar me homologun e tij, Safet Gjici. "Sigurisht që jam i qeshur. E meri-



tonim të fitonim sot, por edhe barazimi është mirë. U bë lojë e bukur, ekipi luajti më mirë. Shpresoj t'i kemi gjunjët. Matematika nuk na e lejon akoma, por shpresojmë", - ishte ky prononcimi i Demit për "Supersport".

Partizani me mungesa të shumta arrin të barazojë me Asanin golin e shënuar nga Rexhinaldo

# Kukësi dështon të ringrihet, Partizani hipotekon titullin

Mbyllet 1-1 në "Loro Boriçi", me të kuqtë që mbeten +9



Jeton Selimi

Me shumë mungesa, me shumë probleme. Me Ardit Hilën që lë fushën në pjesën e parë për shkak dëmtimi. Me Trashin që improvizohet në qendër të mesfushës, me Kalarin që luan si një 18-vjeçar! Ka shumë fjalë për ta përkufizuar këtë ndeshje mes Kukësit e Partizanit, por mjaftojnë vetëm katër, të kuqtë hipotekojnë titullin! Ramadan Ndreu nuk ka kapitenin Shameti dhe Et'hemin të skualifikuar, ndërsa Gega ka shumë më shumë probleme. Mala dhe Hebah në tribunë, Telushi në spital, Idrizaj ka mbyllur sezonin dhe Rexhepi i skualifikuar. Kaq mjafton për të vënë në alarm cilindo trajner, që ka gjysmën e formacionit jashtë, por jo Skënder Gegën. Kukësi e nis më mirë sfidën, Partizani i duhen disa minuta që të gjejë ritmin e "arnimeve" të bëra. Por pas disa momenteve ku Kukësi krijon shkëndija, është Partizani që gjen ritmin e duhur dhe vë jo pak në vështirësi prapavijën. Por nëse Gega ka pasur telashe para ndeshjes, i



shtohet edhe një tjetër. Ardit Hila dëmtohet dhe lë fushën në minutën e 30-të, por kjo nuk demoralizon Partizanin, që bëhen edhe më kërcënues në mesfushën kundërshtarë. Ndreu kërkon të shkundojë titijtë dhe bën ndërrimin e goditur, hedh në fushë Rexhinaldon në fillimin e pjesës së dytë

dhe mozambikasi nuk zhgënjën, kur nga goditja e dënimit çel rezultatit me një gol të shkëlqyer. Në festë Kukësi, Gega kërkon të mbledhë titijtë. Largon Koten, zhvendos Trashin në qendër dhe fut Kalarin në krah. Lëvizje të goditura. Partizani gjen fleksibilitet dhe futet më shpesh në zonë dhe në një moment të tillë, Cuculi pengon Asanin, që fiton një 11-metërsh, të cilin e kthen vetë në gol. 1-1, Kukësi tronditet dhe nuk arrin të bëjë asgjë më tej, ndërsa Partizani me pak kujdes mund të kishë tjetër dhe golin e dytë, por gjithsesi edhe barazimi është i gjithi për t'u përqafuar, pasi me 9 ndeshje nga fundi i kampionatit, distanca mes Partizanit dhe Kukësit mbetet e pandryshuar, 9 pikë.

**TRAJNERI I KUKËSIT**

**Ndreu: Ramë fizikisht, Asani e vodhi penalltinë**

Trajneri i Kukësit, Ramadan Ndreu, debutoi ditën e sotme me verilindorët, por vetëm me një barazim 1-1 ndaj Partizanit, ku prishmëritë ishin të mëdha për një fitore, e për të ngushtuar diferencën me të kuqtë. Pas ndeshjes, tekniku u shpreh se ekipi i tij çdo ditë nga ana fizike dhe Partizani i mori një barazim falë një "vjedhjeje" të penalltisë nga ana e Asanit. Por, e dominoi ndeshjen sipas tij dhe kjo i jep shpresë. "Ka diçka që nuk shkon, por Partizani kishte shumë avantazhe. Kishte pikët, i qetë psikologjikisht dhe luan për barazim. Ia arriti qëllimit. Ne ishim në tension. Skuadra ka probleme fizike, që i shfaq jo vetëm sot, por edhe në takimet e kaluara. Me Teutën patëm probleme në pjesën e dytë. Nuk është mirë fizikisht. Deri tek goli ishim mirë, por kishim frikën e fundit të takimit. Ato janë shenjat e lodhjes. Ishte edhe një vendosje gabim e mbrojtjes të majtë dhe qendërmbrojtjesit. Në përgjithësi ishim të kujdesshëm dhe e kontrolluam lojën. Tani që e shikoj, s'ka lidhje fare me penalltinë. Ai është një lojtar tipik që i vjedh penalltitë. Ai ka marrë topin dhe është përplasur vetë te këmbët e Cuculit".

**TRAJNERI I PARTIZANIT**

Partizani arriti të merrte një pikë të rëndësishme në transfertë përballë Kukësit, duke ruajtur diferencën prej 9 pikësh. Edhe pse kanë mbetur vetëm 9 ndeshje nga fundi i kampionatit, për trajnerin Gega diferenca prej 9 pikësh nuk është e konsiderueshme. Në prononcimin pas ndeshjes për mikrofonin e "Supersport", tekniku i të kuqve foli edhe për deklaratën e trajnerit Alban Bushi në lidhje me gjendjen shëndetësore të Malës, duke u shprehur: **Të gjithë lojtarët bashkë me ju dhe më pas ovcionet. Mund ta pranojmë që jeni shumë pranë titullit...**



Malës dhe çdo lojtar që nuk ishte sot në fushë. Edhe për ata kemi luajtur. Nuk kemi luksin që të zëvendësojmë të gjithë titullarët. Për fat të keq bëmë dhe ndërrime të detyrueshme. Grupi është ai që i kalon gjërat bashkë. Falë grupit morëm pikën e rëndësishme. **Sa e vështirë ishte përgatitja e ndeshjes?** Jam munduar të mos e shfaq presionin te lojtarët. 3

**Gega: Asgjë nuk ka mbaruar, Bushi më habiti me deklaratën**


matematika e lejon. Duhet të jemi me këmbë në tokë. Respekt për rivalin, për potencialin që ka. Ne falë harmonisë dhe mirëkuptimit që kemi, jemi munduar të jemi të gjithë ushtarë. Kemi rrugë për të parë. Do kisha dëshirë ta qetësoja veten, por është e pamundur. Është kalendar i ngjeshur. Sot nuk kisha shumë alternativa. Një pjesë e lojtarëve nuk janë gatë. Jam i lumtur që nuk dolem pa pikë. **Fakti që Kukësi nuk lu ndali as me mungesa, a do të jetë kjo një bonus për titullin?** Lojtarët luajtën për shokët e tyre që mungonin. Nuk e kemi luksin të mungojnë lojtarë si Mala dhe Telushi,

por dhe Hebah. Është një bonus, por unë dëshiroj që ata të rikuperohen dhe t'i hedhin në fushë, duke synuar 3 pikët në ndeshjet e radhës. **A ishte Kukësi ekipi dominues në fushë?** Në 25-minutëshin e parë, Kukësi kapi mesin e fushës. Nuk kapi surpriza. E dinim që nuk do luanim me 2 sulmues. Gjërat nuk funksionuan mirë në mesfushë, iu lamë hapësira. Me pak fat edhe mund t'i ndëshkonim. Ishte lojë e hapur. Besoj se për aq sa kishim në dispozicion, bëmë më të mirën. **A dini ju ndonjë rast ku skuadra kryesuese ka qenë 9 pikë kundërshtarit 10 javë para fundit dhe është përmbytur?**

Unë jam trajner i vjetër, po nuk kam eksperiencë shumë në Superligë. Më duken shumë pak 9 pikë. Të jem i sinqertë. Do të doja që ndeshjen e fundit me Luftëtarin të ishim 7 pikë. **Trajner Bushi sot ka hedhur dyshime të forta se Mala ka bërë si i dëmtuar dhe ka munguar enkas. Kemi një koment për këtë?** Në mëngjes e lexova deklaratën. U shqetësova pak. Mala është sportisti që unë ruaj respektin më të madh. Nga kjo u preka dhe mendova ta telefonoj trajnerin Bushi. Ai ka pasur një goditje. E mora Bushin si koleg, i garantova që Mala është shembullor. Edhe ai e pranoi. E rëndësishme është që Mala është ai që është. Ekipi i Shpresës dhe Kombëtarit u uroj me zemër suksese dhe t'i mbështes lojtarët e vet.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- E famshja Curie
- Më e mira është rekord.
- Inicialet e Kurosawa-s.
- Është edhe ai i mendimeve.
- Një mund të jetë zemërkau
- Është dollapi.
- Gjysmë mimize.
- Fillojnë sefte.
- Është shkollë e Aristotelit.
- Ndodh në kufij.
- Bëhen me ambalazh.
- Janë idhnakë.
- Fillojnë titujt.
- Do të bëhen pemë.
- Ashtu si jeton heremitit.
- Është dhomë e lartë.
- Janë spanjollët dhe portugezët.
- Është filozofi që preu damarët.

- Janë gjuhë...veshi.
- Musketierët e Dumas.
- Lila këngëtare.
- Kufizojnë takimet.
- Ullmann aktore.
- Mbledh baskët separatistë.
- Fillojnë kapjen.
- Inicialet e Delon.
- Lumi i Bernës.
- Është numri të parit.
- Një thirrje me emra.

**VERTIKAL**

- Farrow aktore.
- Me Romeo në makinë.
- Rolet pa zë.
- Kufij itinerari.
- Ai ekzekutiv u bë bashki.
- Në mes të dhomës.
- Një tabu islamike
- Mbyllin fushatat.
- Janë festime
- Lehar kompozitor.
- Janë shtyllat për vela
- Ata të Ferrari-t qëndrojnë në box.
- Duhet fituar me djersë.
- Piktura pa kura.
- Janë dokumente partie.
- Në fund të vitit.
- Farkëtoi armët e Akilit.
- Një është për kërcim.
- Athinaja e romakëve.
- Janë kapriçiot.
- Një tis mjegulle.
- Kërcimi i Fred Astaire.
- Edwards regjisor.
- Parker regjisor.
- Luan në kufij
- Inicialet e Rohmer.
- Fillojnë detyrën.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- Lama i Tloetit.
- Janë vendet e lira
- Martin i Jack London.
- Comaneci e famshme e gjimnastikës.
- Ekstremit në sirtar.
- Janë princëtarabë.
- Një treshe në skenë.
- Një provë inteligjence.
- Gjysmë tatimi.
- Gjysmë eolike.
- Ekstremit në studim.
- Bëjnë stil të lirë
- Ndaj në kufij
- Kaluar në krye.
- Një tragjedi... e Dreiser.
- Grier aktore.
- Dashi kur mungon ai
- Është zanore në filma
- Kufizohet në kufij
- Ente Civile Europiane.
- Janë galeri në rrugë.

**VERTIKAL**


- Është halli.
- Fillon me rruga...
- Kastile janë në fund
- Janë në skajë
- Është vendi aderues
- Ka kryeqytet Doha.
- Incialet e Daudet.
- Ndërmarrje Industriale Tiranë.
- Igli te Lazio.
- Janë zjarrvënës.
- Flanders e Defoe.
- Shkroi Rimoceroniti.
- Ekstremit në slam.
- Janë trille.
- Qytet italian.
- Jepen për hartim.
- Fillojë takimet.
- Kufizojnë kënde.
- Janë vendet e para.
- Një greminë.
- Është logarin që qërohet.
- Ndiquen me ilaçe.
- Masari aktore italiane.
- Është melodramë.
- Një thirrje e dëshiruar nga maja e direktut.
- Kush ka... fërgëllton.
- Një i fundit mbi të gjithë.
- Një pjesë e satelitëve.
- Në krye të njerëzve.
- Sikur janë në krye.
- Inicialet e Taylor që që aktore..



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

M A T T I S S E K A L A T E  
 I R O N H B I D O N E T  
 A O P E R A A L E T I  
 S T E A N A T E M A T  
 K P E L I K A N I A T A  
 E P I D E M I K E R E S  
 D O R O T E A A L B E R T  
 I L M T M I E T A  
 N A S S P A K O T S R  
 A K T U A L I T E T T A  
 T E A M E R E T N E R  
 T R A G E T I A I D A N

**FJALËKRYQI (2)**

A V A B B A A L M A  
 P U A M A R E T A T A R  
 E S F E R A I N O R A  
 L A T L I P O T I M I A  
 M O N O T O N E T R I T  
 S A L D O R R A O N E  
 E T I I N T E R U N I  
 N O T I E T I N R T I  
 D R E R E T E N T K P  
 E A S I A O M E R A  
 S T I N A K U R R E A R  
 P M I T E T E S T E T I

**SUDOKU**

9				7				
6				4		2		
		4						
				2	9		4	
8	3							
		1				5	8	
	5			8				
		7	4	3				1
				1				2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	4	9	3	8	1	7	5	6
6	1	5	4	9	7	8	2	3
3	7	8	2	5	6	9	4	1
7	9	4	6	1	8	5	3	2
1	5	2	9	7	3	6	8	4
8	3	6	5	4	2	1	7	9
5	6	1	8	3	4	2	9	7
4	8	7	1	2	9	3	6	5
9	2	3	7	6	5	4	1	8

*Argëtim filozofik*

- I talentuari bën atë që mundet. Gjenui bën atë që duhet.
- Miq të mirë, është e vështirë për ti gjetur, akoma më e vështirë për të braktisur ata, dhe është e pamundur për ti harruar ata.
- Rruga drejt suksesit është gjithmonë në ndërtim e sipër.
- Një lutje nuk ndryshon asgjë, por një vendim mund të ndryshojë çdo gjë!
- Nëse njerëzit flisnin vetëm për atë që ata kuptojnë, heshtja që do të mbizotëronte në botë do të ishte e padurueshme.
- Kur virtyti ka rënë në gjumë, do të zgohet më i fresket.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

4	6	8	3	6	10	10	4	16	3	2	V	A	P	E	N	I	V	O	D	K	A			
10	3	9	5	7	4	8		6	12	4	A	R	A	H	E	L	M	I	M	I	D			
4	4	19	4	11	1	2	3	18	5	2	T	I	P	E	R	I	O	D	I	K	A			
18		11	5	6	5	13	5	9	4	7	3	2	E	M	O	D	E	R	N	E	T	T	P	
5	12	3	2	5	6	3	2	9	5	5	R	E	I	D	I	O	A	O	T					
		6	4	2	4		17		4	1	5		P	A	R	A	D	A	A	T	R			
5	2	3		3	7		2	5		4	6	1	P	E	A	K	I	L	O	N	I			
13	3	12	3	2	3		4	2	5	13	5		R	A	S	T	E	D	E	N	I	R	O	
2	13	16			2	3	5	12		2	5		O	L	E	L	E	S	T	E	T	T		
17	12	4	1	12		7	6		2		13		V	H	I	E	N	A	E	N	T	O		
5	4		7	4	8	4	1	12	5	6	4	2	A	R	I	A	N	E	T	R	R	A	P	
9	13	8		2	17	6	4	8	2	3	2		T	E	R	R	I	T	O	R	D	E	T	I

*Thënie të mençura*

- Besoj vetëm vetes tënde në jetë, sepse njerëzit nuk të kuptojnë, të gjykojnë, të godasin, e mbi të gjitha kënaqen kur të lëndojnë.
- Kush ul veten kërkon të ngrihet.
- Mjeti kryesor i të gjitha magjepsjeve është ai i shtënë në dorë të diçkaje që i përket një tjetri.
- Varësia e opinionëve, e shëndërruar në instinkt falë zakonit, çon drejt asaj që quhet forcë karakteri.
- Më e lavdueshme është ajo grua, emri i së cilës shpëtohet më pak nga buzët e burrave, qoftë për lëvdata, qoftë për sharje.

